



# MANUAL PËR AKTIVITETE MBI MENDJEN, EMOCIONET DHE PRAKTIKËN NË KLASË

Prishtinë, nëntor 2020



Implemented by

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

**KYC** KOSOVAR  
YOUTH COUNCIL



**Titulli:** Manual për aktivitete mbi mendjen, emocionet dhe mendjen në klasë

**Autore e manualit:** Gresa Statovci

**Kontribuese:** Agnesa Qerimi

**Botues:** Këshilli Rinor Kosovar – KYC

**Foto kredit:** 2010 SuperStock

**Dizajni:** BubaGraphics L.L.C

#### Klauzola

Ky manual paraqet përmbledhje aktiviteteve jo-formale të hulumtuara dhe të përshtatura në njësi dhe kapituj shtjellues në tri kategori aftësish a) aftësitë kognitive, b) aftësitë emocionale, c) aftësitë praktike që një i ri apo e re mund ti përvetësoj përmes aktiviteteve jo-formale edukative të shtjelluara në manual dhe mund të adaptohen nga institucione formale si shkolla apo dhe organizata qeveritare, jo-qeveritare, grupe formale dhe jo-formale.

Manuali është pronë e Këshillit Rinor Kosovar prandaj dhe kopjimi dhe shumëzimi i tij pa lejen e Këshillit Rinor Kosovar nuk lejohet.

**Përgjegjësia:** Ky material është zhvilluar me mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

## TABELA PËRMBLEDHËSE

<b>Hyrje</b> .....	<b>5</b>
<b>Përmbajtja e Manualit</b> .....	<b>7</b>
Kapitulli – Aftësitë Kognitive – .....	7
Kapitulli – Aftësitë emocionale dhe shoqërore – .....	7
Kapitulli – Aftësitë praktike jetësore – .....	7
<b>Metodologjia</b> .....	<b>8</b>
<b>Manuali për aktivitetet mbi mendjen, emocionet dhe praktikën në klasë</b> .....	<b>9</b>
<b>Aftësitë Kognitive</b> .....	<b>9</b>
Matriksa e Zgjidhjes së Problemeve .....	23
Grafet .....	26
SWOT Analiza .....	28
<b>Aftësitë Emocionale</b> .....	<b>29</b>
Leximi .....	37
Skenari .....	42
<b>Aftësitë Praktike</b> .....	<b>47</b>

# Hyrje

*“Ju mund ta quani individualitetin me shumë emra. Transformim. Metamorfozë. Falsitet. Tradhëti. Unë e quaj Edukim.” – Tara Westover – Libri “Edukuar”*

Edukimi është më shumë se formulë matematikore, është më shumë se mbajtje në mend e lakmit nëpër rasa të një foljeje. Është ekzistencë bashkë-shoqërore, mirëqenie individuale dhe grupe. Për të qenë i/e gatshëm/e për t'i përballur preokupimet jetësore, dyshimet ekzistencialiste, tempon kohore, mjedisin si dhe për t'i njohur përgjegjësitë karshi të drejtës që zotron, atëherë do të kishte qenë e nevojshme që të përmbushesh dhe aftësohesh kognitivisht, emocionalisht dhe praktikisht. Këto aftësi përfitohen me ndërthurje të plotë të arsimimit gradues dhe reformes me bazë në shkollë dhe edukim jo-formal praktik - me bazë në komunitet e cila gjë jo gjithmonë mund të arrihet në klasë formale, lëndore. Rrjedhimisht, “manuali për aktivitete mbi mendjen, emocionet dhe mendjen në klasë” mëton të ofroj mundësi më të gjëra aktiviteti për formësim të edukimit jo-formal që mund të zbatohen në klasë gjatë një ore mësimore, përgjatë mësimit plotësues apo jashtë-shkollor si dhe përgjatë aktiviteteve jo-formale në komunitet.

Duke pasur në konsideratë që një sistem edukimi cilësor duhet dizajnuar për qëllim të zhvillimit të fëmijëve që në moshë të hershme që të adaptojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura për t'u përgatitur për një treg konkurrues të punës dhe të njëjtën kohë për t'u kthyer në qytetarë aktiv, e kontribuues/e të ndryshimit shoqëror, dhe duke marrë për bazë sfidat me të cilat ballafaqohet konkretisht sistemi edukativo-arsimor kosovar, Këshilli Rinor Kosovar (në vazhdim: “KYC”) ka ndërmarrë iniciativën për përpilim dhe zhvillim të “it për aktivitete mbi mendjen, emocionet dhe mendjen në klasë”

Ky manual, si dokument i përveçëm ka për qëllim të kontribuoj dhe lehtësoj mësimdhënien dhe të nxëniet adekuat referuar reformave arsimore në Kosovë, dhe do të mund të shfrytëzohet për arsimimin dhe edukimin e nxënësve mbi aftësitë e të menduarit kritik dhe kognitiv, aftësitë emocionale dhe shoqërore, dhe aftësitë praktike jetësore. Mbështetur në dokumentin bazë që definojnë qëllimet e arsimit në Kosovë, kryesisht në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Para-universitar të Republikës së Kosovës (në vazhdim: “Korniza e Kurrikulës”). Kjo Kornizë ndër të tjera identifikon këto qëllime të arsimit:

- Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore
- Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare
- Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit
- Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore
- Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm
- Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

Rrjedhimisht, përveç ndikimit në përmbajtjen e Kornizës Kurrikulare, ky manual ndër të tjera ka për qëllim t'i shërbej për përdorim metodologjisë së mësim-dhënies. Kategoritë e elaboruara me aktivitete konkrete, lirshëm mund të adaptohen në plan të punës së mësimdhëniesit/es, për t'i arritur kështu kompetencat e të nxëniet siç përcaktohen në Kornizën e Kurrikulës (2016), e që janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit

- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Përveç, metodologjisë së mësim-dhënies, ky manual do të mund të shërbej dhe për përmbushje të aktiviteteve jashtë-shkollore, për më tepër lehtëson zbatimin e paragrafit 1.4 të nenit 1, të Udhëzimit Administrativ nr.02/2016 Për Aktivitete jashtë-shkollore, hyrë në fuqi më 2016, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Si dhe, mund të njësohet dhe përdoret nga individë, grupe jo-formale dhe entitete të tjera si organizata të shoqërisë civile që zhvillojnë programe për të arritur të njëjtin qëllim.

# Përmbajtja e Manualit

## Kapitulli – Aftësitë Kognitive –

Aftësitë njohëse apo kognitive, nënkuptojnë aftësitë jo vetëm të marrjes së informacionit, por edhe të shtjellimit të tyre. Për më shumë, njohja e tillë nënkupton aftësinë e të menduarit mbi informacionin e marrë, aftësinë për të procesuar informacionin si dhe aftësinë për të diskutuar në lidhje me informacionin. Do të thotë, përmes pasurimit të aftësisë kognitive një fëmijë, i/e ri/re, do të jetë në gjendje që informacionin e ri ta aplikojë në kushte të zakonshme të jetesës dhe veprimtarisë individuale e shoqërore.

Duke pasur parasysh rëndësinë e një aftësie të tillë për nxënësin e shkollimit para-universitar, kapitulli “aftësitë kognitive” trajton dhe ka për qëllim zhvillimin e aftësive të trurit për të mësuar, mbajtur në mend, zgjidhur probleme, dhe për të kushtuar vëmendje kundrejt të gjitha aktiviteteve që ndodhin.

## Kapitulli – Aftësitë emocionale dhe shoqërore –

Intelegjenca emocionale, konsiderohet të jetë aftësia për të identifikuar, vlerësuar, kontrolluar dhe shprehur emocionet. Ndër të tjera, një aftësi e tillë, ndihmon nxënësin/en që të i përdor ndjenjat e tij/saj për ti identifikuar dhe zgjidhur sfidat që i paraqiten, si dhe u ndihmon në komunikim me të tjerët por dhe përmes fuqisë së njohjes së sfidës dhe njohjes së ndjenjave të veta arrin të pavarësohet në marrjen e vendimeve. Përveç të tjerash, aftësimi emocional kontribuon tek nxënësi për menaxhim të vetvetes por dhe të tjerëve përreth. Si dhe, ua zhvillon vetëbesimin dhe motivimin vetanak për mësim-nxënie.

Në këtë rast, kapitulli “*Aftësitë emocionale dhe shoqërore*” i këtij manuali ka për qëllim zhvillimin e aftësive të nevojshme që nxënësit të njohin dhe kontrollojnë emocionet dhe sjelljet e tyre; krijojnë dhe mbajnë marrëdhënie pozitive; të marrin vendime të përgjegjshme dhe të zgjidhin situata sfiduese; të vendosin dhe të arrijnë synime pozitive.

## Kapitulli – Aftësitë praktike jetësore –

Aftësitë praktike janë elementi kryesor i mësim-nxënies së përgjeshme, përmes së cilave nxënësi përfiton shkathtësi, njohuri dhe kompetencat e duhura për t’u përshtatur me profesione të veçanta dhe tregun e punës. Por, përveç si përgjigje ndaj zhvillimit profesional e ekonomik, aftësi të tilla janë të nevojshme edhe për zhvillim personal dhe atë të pjesëmarrjes së qytetarisë aktive.

Përmes kapitullit “*Aftësitë praktike jetësore*”, ky manual ndër të tjera ka për qëllim zhvillimin e aftësive praktike që ndërlidhen me të nxënit e dy kategorive të para, për të ofruar qasje të lehtë të praktikimit të nxënit brenda dhe jashtë kornizës lëndore dhe hapësirave shkollore. Ky kapitull, do të kontribuoj që nxënësit të përvetësojnë aftësi që janë të nevojshme të posedohen për jetën shoqërore dhe zhvillim, duke përfshirë këtu aftësitë vendim-marrëse, vullnetare, artistike dhe mjedisore për t’u kthyer kështu në qytetarë aktiv dhe produktiv.

Rrjedhimisht, temat të cilat do të shtjellohen përmes aktiviteteve të këtij manuali do të jenë të ndërlidhura kryekëput me qëllimet e Kornizës Kurrikulare dhe degëzimit të saj në rezultatet e të nxënit në Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët të Kosovës (Klasa VI-IX), Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës (Gjimnazet- klasa X,XI,XII) si dhe Kurrikulat Lëndore.

Disa nga temat do të përfshijnë: hulumtimin dhe analizën e të dhënave dhe materialeve të ndryshme online, paraqitjen dhe interpretimin e të dhënave, udhëheqja dhe menaxhimi, ndërmarrësia dhe inovacioni, metodat e ndërmjetësimit në konflikte, barazia gjinore dhe shoqërore, paragjykimet, puna vullnetare etj.

# Metodologjia

Këshilli Rinor Kosovar- KYC si organizatë jo qeveritare që ka nën ombrellë Këshillin e Nxënësve të Kosovës si strukturë përfaqësuese e nxënësve të të gjitha shkollave të mesme në Kosovë, (gjimnazet dhe shkollat profesionale) dhe është në zhvillim e sipër të strukturës përfaqësuese edhe të shkollave të mesme të ulëta. Gjithashtu, duke qenë se KYC punon për ngritjen e cilësisë së arsimit në vend, duke marrë parasysh gjithmonë si pikë fillestare perspektivën e nxënësit për të i kontribuar qëllimit të arsimit në Kosovë sipas Kornizës së Kurrikulës, rrjedhimisht ka iniciuar këtë manual, dhe të gjitha aktivitetet e paraqitura kanë për synim të lehtësojnë metodologjinë e punës së mësim-dhënies për të arritur kështu rezultatin e aktivitetit dhe interaktivitetit të nxënësve dhe të rinjve në klasë, shkollë, lagje apo komunitet. Gjithashtu, si bazë për krijimin e aktiviteteve janë marrë kompetencat kryesore të nxënësve në Kornizën e Kurrikulës së Re të Kosovës, dhe për secilën kompetencë janë krijuar aktivitete me qëllim të zhvillimit të tyre. Secili aktivitet e ka të specifikuar qëllimin dhe secili qëllim përkon me kompetencat që nxënësit duhet të zhvillojnë gjatë shkollimit, sipas niveleve. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve janë marrë parasysh mungesa e burimeve dhe materialeve në shkollë apo ambiente të ndryshme arsimore dhe rrjedhimisht, aktivitetet nuk kërkojnë shumë materiale për zbatimin e tyre.

Për të zhvilluar një manual sa më cilësor, KYC ka angazhuar nën kompetencë të plotë, njohës të fushës së edukimit, por dhe të gjithë stafin aktiv për të matur punën dhe bazën e të dhënave të nxjerra për vite të tëra të punës në terren, e specifikisht të dhënat e listuara si nevoja të nxënësve të shkollave të nivelit 2 dhe 3 të Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (ISCED), gjatë zbatimit të projektit “Ndërtimi i një gjenerate me ndikim, përmes fuqizimit të Këshillave të Nxënësve”. Poashtu, është zhvilluar hulumtim i literaturës paraprake në fazë tre mujore, hulumtim krahasues i manualëve të ngjashëm të përdorur për kuadro e fusha të ndryshme në vende të ndryshme evropiane, dhe janë marrë në perspektivë nga zhvilluesja e manualit për të plotësuar sa me më detaje secilën kompetencë dhe qëllim që tenton të arrihet.

Përveç të tjerash, për ti shërbyer plotësimin të manualit, në kuadër të hulumtimit, Këshilli Rinor Kosovar ka organizuar gjashtë (6) fokus grupe, për prezantim dhe diskutim të aktiviteteve që duhet përfshihen në manual dhe të cilat mund të zhvillohet lehtësisht në ambiente shkollore. Fokus grupet janë mbajtur në Prishtinë, Prizren, Gjilan, Gjakovë, Shtime dhe Obiliq (komuna të përfshira në kuadër të projektit “Building School Community by Empowering Students” që zbatohet nga KYC nën mbështetje Qeverisë Gjermane, Agjensionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ, projektit Ngritja e Kapaciteteve në Arsimin Fillor CDBE ku pjesëmarrës kontribues kanë qenë mësimdhënës, drejtorë/e, psikologë, pedagogë dhe ekspert të arsimit para-universitar nga komunat përkatëse.

Aktivitetet e këtij manuali janë të qarta, të shtjelluara që nga qëllimi, mënyra e realizimit, koha dhe mjetet që mund të përdoren, rrjedhimisht mund të zbatohet nga mësimdhënësit, prindërit, dhe të gjithë hisedarët e tjerë të përfshirë në arsim.



# Manuali për aktivitetet mbi mendjen, emocionet dhe praktikën në klasë

## Aftësitë Kognitive

Kapitulli “*Aftësië Kognitive*” përfshinë aktivitete për zhvillimin e aftësive të të menduarit, pra aftësi inteligjence apo njohëse. Aftësitë kognitive janë aftësitë e trurit për të mësuar, mbajtur në mend, zgjidhur probleme, dhe për të kushtuar vëmendje kundrejt të gjitha aktiviteteve që ndodhin. Fokus të veçantë në këtë kapitull dhe në manualin në tërësi ka zhvillimi i mendimit kritik i nxënësve duke ju mundësuar nxënësve të analizojnë dhe vlerësojnë situata të ndryshme duke u bazuar në mendim strategjik dhe inovativ.

Aktivitetet në këtë kapitull kanë për qëllim zhvillimin e këtyre aftësive kognitive:

- **Perceptimi** – mënyra se si nxënësit identifikojnë dhe interpretojnë aktivitetet përreth.
- **Fokusi** – mënyra se si nxënësit mbajnë koncentrimin në temë pa u ndikuar nga faktorë të jashtëm.
- **Memoria/Kujtesa** – mënyra se si nxënësit zhvillojnë mbajtjen mend në periudhë afat-shkurtër dhe afat-gjatë.
- **Mendimi racional dhe logjik** – mënyra se si nxënësit marrin vendime duke u bazuar në racionalitet dhe logjikë.
- **Komunikimi** – mënyra se si nxënësit komunikojnë duke u bazuar në informatat përreth.

Përmes këtyre aktiviteteve synohet arritja e qëllimeve dhe shkallëve të aftësisë të paraqitura në Kurrikulën Bërthamë të Kosovës dhe në Kornizën e Re të Kurrikulës së Kosovës. Secili aktivitet përmbanë (1) Qëllimin; (2) Definicionet dhe Fjalët kyçe; (3) Materialet dhe opsione zëvendësuese të materialeve; (4) Përshkrimin e aktivitetit (Udhëzime, Pyetje dhe Përgjigje), si dhe disa kanë si opsionale (5) Detyra shtesë për shtëpi.

Aktivitetet e paraqitura për zhvillimin kognitiv, përveç se zhvillojnë aftësitë kognitive, gjithashtu përmbajnë tema të ndërlidhura me inteligjencën emocionale dhe punën praktike. Secili aktivitet ka anekse të bashkëngjitura, por mësimdhënësi ka mundësinë të ndërrojë disa prej tyre varësisht nga aktiviteti, përderisa i përmbahet qëllimit dhe përshkrimit të aktivitetit.

Aktivitetet janë të ndara sipas niveleve klasore dhe janë kryesisht të përshtatshme për të gjitha nivelet. Natyrisht, niveli i diskutimit dhe parashtrimin të pyetjeve duhet të përshtatet nga mësimdhënësi/fasilitatori duke u bazuar në nivelin klasor.

Koment shtesë: Disa na aktivitetet në këtë kapitull janë bazuar në pyetjet e testit PISA në fushën e leximit dhe matematikës, dhe janë modifikuar në përputhje me strukturën e këtij manuali.

<b>Titulli</b>	<b>Emri im</b>
<b>Qëllimi</b>	Kultivimi i interesimit për njohje më të thellë të vetes, të tjerëve dhe të mjedisit natyror e shoqëror.
<b>Niveli</b>	Klasa 7, 8, 9, 10
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	<b>Identiteti:</b> karakteri apo personaliteti dallues i një individi, përfshirë emri, statusi familjar, religjioni, etniciteti.
<b>Materialet</b>	Opsioni 1: Të paraqitet tregimi “Emri im”, faqe 7, në projektor. Opsioni 2: Të printohet tregimi “Emri im” për secilin nxënës. Opsioni 3: Të lexohet nga mësimdhënësi ose një nxënës për të gjithë klasën.
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	Tregimi “Emri im”, aneks 1, lexohet i ndarë në paragrafe duke u parashtruar pyetje për të gjithë nxënësit pas secilit paragraf.  Këto janë pyetjet që duhet të parashtrohen pas secilit paragraf dhe përgjigjet e mundshme për secilin. Ky tregim nuk ka përgjigje definitive apo përgjigje të pasaktë, por inkurajoheni të drejtoni diskutimin rreth këtyre përgjigjeve pasi të shterën të gjitha përgjigjet nga nxënësit.
<b>Paragrafi i parë</b>	Në anglisht emri im do të thotë Shpresë. Në spanjisht do të thotë shumë shkronja. Do të thotë trishtim, do të thotë të presësh. Është si numri nëntë. Një ngjyrë e zymtë. Është si këngët meksikane që babai im luan gjatë mëngjesit të së dielës kur ai rruhet, këngë vajtuese.  1. Çfarë paraqet ky paragraf? Përgjigje: Përshkrimi i emrit në gjuhë të ndryshme dhe si i ndryshon kuptimi varësisht nga gjuha dhe kultura.  2. Me çka e krahason emrin shkrimtarja? Pse? Përgjigje: Emrin e krahason me numrin nëntë, me ngjyrë të zymtë dhe me këngët e dhimbshme meksikane. Këto i përdor si simbole për të paraqitur gjendjen e saj emocionale, dhe për të treguar që emri i saj, në këtë rast kultura e saj, kanë të bëjnë shumë me identitetin e saj.
<b>Paragrafi i dytë</b>	Ishte emri i gjyshes sime dhe tani është i imi. Ajo ishte gjithashtu një grua e fuqishme si kuajt, e lindur si unë në vitin kinez të kalit - që supozohet të jetë fat i keq nëse lindni femër - por unë mendoj se kjo është një

	<p>gënjeshtër kineze sepse Kina, si Meksika, nuk i do gratë e tyre të forta.</p> <p>1. Çfarë paraqet ky paragraf?</p> <p>Përgjigje: Paraqitja e emrit si vazhdimësi e kulturës dhe identitetit familjar ngaqë është trashëguar nga gjyshja.</p> <p>2. Pse përmendet kalendari kinez dhe mospëlqimi i idesë së gruas së fuqishme?</p> <p>Përgjigje: Pjesa e dytë e paragrafit tregon për ngjashmëritë në mes të nacionaliteteve të ndryshme kundrejt fuqizimit të gruas, pra nuk ju pëlqejnë gratë e fuqishme dhe gjejnë arsyetime (p.sh fat i keq të lindësh grua në vitin e fuqishëm të kalit).</p>
<p><b>Paragrafi i tretë</b></p>	<p>Gjyshja ime. Do të më pëlqente ta njihja atë, një grua porsi kali i egër, aq e egër që nuk donte të martohej. Derisa gjyshi im hodhi një thes mbi kokën e saj dhe e iku. Ashtu, sikur të ishte një llambadar i zbukuruar. Koha kalonte por ajo kurrë nuk e fali. Ajo shikoi jashtë dritarës tërë jetën e saj, në mënyrën se si shumë gra e pushojnë trishtimin e tyre në një bërryl. Pyes veten nëse ajo e bëri më të mirën nga ajo që kishte apo i vinte keq sepse nuk mundi të ishte gjithçka që ajo dëshironte të ishte. Shpresa. Unë kam trashëguar emrin e saj, por nuk dua ta trashëgoj vendin e saj tek dritarja.</p> <p>1. Çfarë paraqet ky paragraf?</p> <p>Përgjigje: Traditën kulturore për martesë; si burri i familjes e ka trajtuar si një objekt dhe e ka martuar pa dëshirën e saj.</p> <p>2. Çfarë do të thotë “mënyra se si shumë vajza e pushojnë trishtimin e tyre në një bërryl” dhe përse ndodh kjo?</p> <p>Përgjigje: Vajzat ndër shekuj kanë hezituuar të protestojnë trishtimin e tyre, dhe e kanë përjetuar këtë trishtim në vetvete pa pasur mundësi të kërkojnë diçka më ndryshe. Kjo ndodh për shkak të patriarkatit – udhëheqjen e shoqërisë nga burrat – të cilët kanë vendosur për fatin e vajzave dhe nuk ju kanë lënë hapësirë të shumtë për vendimmarrje.</p>
<p><b>Paragrafi i katërt</b></p>	<p>Në shkollë ma thonë emrin tim në mënyrë qesharake, sikur rrokjet të ishin bërë prej kallaji dhe të dëmtonin qiellzën e gojës së tyre. Por në spanjollisht emri im është diçka më i butë, si argjendi, jo aq i trashë sa emri i motrës – Magdalena - që është më i shëmtuar se emri im. Por, Magdalena të paktën mund të kthehet në shtëpi dhe të bëhet Nena. Por unë jam gjithmonë Shpresa.</p> <p>1. Çfarë paraqet ky paragraf?</p> <p>Përgjigje: Ndryshimet në perceptime nga kultura në kulturë, dhe ndikimet që mund ti ketë në personat që përjetojnë ndryshime kulturore, sidomos në shqiptimin e emrit.</p>

2. Si i shpjegoni dy fjalitë e fundit?

Përgjigje: Shpresa nuk sheh shpresë në ndryshimin e identitetit të saj, as duke i japë një nofkë emrit të saj. Duket se ajo ka dëshirë që të paktën të ketë mundësinë e ndryshimit të emrit të saj në shtëpi – ndoshta të ketë lirinë e motrës së saj të paktën në shtëpi.

### Paragrafi i pestë

Do të dëshiroja ta pagëzoja veten nën një emër të ri, një emër që tregon më shumë për mua, atë anë që askush nuk e sheh. Shpresa si Lisandra ose Maritza ose Zeze X. Po. Diqka si Zeze X do të kryente punë.

1. Çfarë paraqet ky paragraf?

Përgjigje: Dëshirën e Shpresës të ndërrojë emrin e saj dhe të vë emrin që e identifikon personalitetin dhe thellësinë e saj që askush nuk mund ta sheh.

2. Pse “Zeze X”?

Përgjigje: Emri është identiteti i parë që i jepet një personi dhe është faktori bazë që na identifikon nga njëri tjetri. “Zeze X” mund të simbolizojë shumë gjëra: (1) Shpresa nuk e din çfarë personaliteti ka dhe dëshiron ta ketë emrin si “e panjohur”; (2) Shpresa do ta ndryshojë emrin e saj që të mos identifikohet me gjyshen e saj dhe jo-barazinë gjinore që i ka ndodhur; (3) në momentin që ndërrohet emri atëherë ka mundësi në ndërrimin e jetës dhe si keni qenë i identifikuar deri tani.

3. Nëse do të ndërronit emrin, si do ta bënit? Pse? Çfarë ndikimi do të ketë në jetën tuaj?

4. Çfarë mendimi keni për trajtimin e gruas në shoqërinë kosovare? A i ngjason asaj në këtë tregim?

### Aneks 1

Emri-im

#### **Sandra Cisneros**

Në anglisht emri im do të thotë Shpresë. Në spanjisht do të thotë shumë shkronja. Do të thotë trishtim, do të thotë të presësh. Është si numri nëntë. Një ngjyrë e zymtë. Është si këngët meksikane që babai im luan gjatë mëngjesit të së dielës kur ai rruhet, këngë vajtuese.

Ishte emri i gjyshes sime dhe tani është i imi. Ajo ishte gjithashtu një grua e fuqishme si kuajtë, e lindur si unë në vitin kinez të kalit - që supozohet të jetë fat i keq nëse lind femër - por unë mendoj se kjo është një gënjeshtër kineze sepse Kina, si Meksika, nuk i do gratë e tyre të forta.

Gjyshja ime. Do të më pëlqente ta njihja atë, një grua porskali i egër, aq e egër që nuk donte të martohej. Derisa gjyshi im hodhi një thes mbi kokën e saj dhe e iku. Ashtu, sikur të ishte një llambadar i zbukuruar. Kjo bëri ai. Dhe koha kalonte por ajo kurrë nuk e fali. Ajo shikoi jashtë dritarja tërë jetën e saj, në mënyrën se si shumë gra e pushojnë trishtimin e tyre në një bërryl. Pyes veten nëse ajo e bëri më të mirën nga ajo që kishte apo i vinte keq sepse nuk mundi të ishte gjithçka që ajo dëshironte të ishte. Shpresa. Unë kam trashëguar emrin e saj, por nuk dua ta trashëgoj vendin e saj tek dritarja.

Në shkollë ma thonë emrin tim në mënyrë qesharake, sikur rrokjet të ishin bërë prej kallaji dhe të dëmtonin qiellëzen e gojës së tyre. Por në spanjollisht emri im është diçka më i butë, si argjendi, jo aq i trashë sa emri i motrës – Magdalena - që është më i shëmtuar se emri im. Por, Magdalena të paktën mund të kthehet në shtëpi dhe të bëhet Nena. Por unë jam gjithmonë Shpresa.

Do të dëshiroja ta pagëzoja veten nën një emër të ri, një emër që tregon më shumë për mua, atë anë që askush nuk e sheh. Shpresa si Lisandra ose Maritza ose Zeze X. Po. Diçka si Zeze X do të kryente punë.

<b>Titulli</b>	<b>Lajm i vërtetë apo lajm i rremë</b>
<b>Qëllimi</b>	Qëllimi i këtij aktiviteti është zhvillimi i njohurive dhe aftësive për identifikimin e informatave të besueshme në burime të ndryshme informative; lajme dhe artikuj në uebfaqe të ndryshme në internet.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	Burime informative në internet: Portale dhe uebfaqe të ndryshme në internet që publikojnë lajme dhe artikuj Burime të besueshme: Burime që janë të hulumtuara dhe të bazuara në fakte të vërteta. Lajm i rremë: Lajm që nuk është i bazuar në burime të besueshme.
<b>Materialet</b>	Gjetja e një artikulli të vërtetë nga burim i besueshëm si detyrë shtëpie nga secili nxënës; <i>kërkohet nga nxënësit një ditë para aktivitetit.</i>
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	Nxënësit ndahen në grupe nga gjashtë. Pastaj, ndahen në çifte dhe i lexojnë njëri tjetrit artikujt që i kanë gjetur në internet. Vetëm ata/ato dy në çift duhet të dijnë se cilat janë artikujt e vërtetë – 5 minuta.  Pastaj, secili çift duhet të shtojë edhe një artikull të rremë që nuk është i bazuar në fakte – 10 minuta.  Secili çift lexon të tre artikujt për grupin, dhe dy çiftet tjera duhet të qëllojnë cili është artikulli i rremë – 15 minuta.  Përzgjidhet artikulli më i mirë i rremë në grup – që nuk ka qenë lehtë të zbulohet që ishte i rremë - dhe lexohet në gjithë klasën, pra një artikull për grup – 5 minuta.  Diskutim: Pyetjet pas vlerësimit – 10 minuta
<b>Udhëzime</b>	Secili çift duhet ti keni nga dy artikuj nga interneti por që vijnë nga burime të besueshme dhe bazohen në fakte të vërteta.  <i>(Paraprakisht, mësimmshënësi/ja, lehtësuesi/ja mund të japin informata mbi burimet e besueshme, mënyrën se si e kupton çfarë është burim i besueshëm e çka jo, si dhe rëndësinë)</i>

Ju keni për detyrë që të shtoni edhe një artikull shtesë që nuk është i bazuar në fakte, pra është artikull i rremë. Por, ju duhet ta bëni këtë artikull sa më të besueshëm ngaqë artikulli i rremë fitues do të përcaktohet nëse sa më shumë nxënës nuk mund të ja qëllojnë se cili është artikulli i rremë.

Së pari, lexoni artikujt në çifte dhe pastaj në çifte shkruani një artikull të rremë. I keni 15 minuta kohë. Pasi të përfundojë koha, nga një nxënës i lexon për grupin dy artikujt e vërtetë dhe atë të rremë. Anëtarët tjetër të grupit duhet të ja qëllojnë se cili ishte artikulli i rremë. E njëjta procedurë vazhdon edhe me dy çiftet tjera. Pastaj, përzgjidhet artikulli më i mirë i rremë në grup – që nuk ka qenë lehtë të zbulohet që ishte i rremë - dhe lexohet në gjithë klasën.

### Pyetjet pas vlerësimit

1. Në çka jeni fokusuar gjatë shkrimit të artikullit të rremë?
2. Si vendosët se cilat fakte ti bëni të rreme?
3. Si vlerësuat nëse artikulli është i rremë apo i vërtetë? Në çka u fokusuat më shumë?
4. Si do të vlerësonit nëse artikujt janë të rremë apo të vërtetë në internet? Kjo pyetje mund të jetë si detyrë shtesë për nxënësit të hulumtojnë në internet në shtëpi. (Përgjigje të mundshme: hulumtimi i burimit informativ nëse është i besueshëm, identifikimi i autorit, ri-shikimi i fakteve në internet nëse mbështeten nga burime tjera).

<b>Titulli</b>	<b>Debat</b>
<b>Qëllimi</b>	Përbalje me zgjidhjen e çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me tema nga jeta reale dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive debatuese dhe argumentuese.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	Debat: Diskutim i përgatitur për një temë të veçantë në të cilin parashtrihen argumente të kundërta nga njëra tjetra. Argument: Një arsye ose një tërësi arsyesh të dhëna me qëllim bindjen e të tjerëve se një veprim ose ide është e drejtë ose e gabuar. Fakt: Një gjë që dihet ose vërtetohet e vërtetë.
<b>Materialet</b>	Shkrimi i temave në tabelën e zezë.
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	Aktiviteti përfshin debat konstruktiv rreth temave nga jeta reale të përshkruara më poshtë. Nga nxënësit pritet të krijojnë argumente dhe të shtojnë fakte, apo shembuj, që e përkrahin argumentin e tyre. Nxënësit ndahen në grupe nga gjashtë dhe duhet të shkruajnë dy deri në katër argumente për temën e dhënë, dhe për anën e caktuar. Grupet nga gjashtë nxënës ndahen nga tre nxënës dhe grupi i parë argumenton në favor të temës, ndërsa grupi i dytë argumenton kundër temës. Nëse janë katër grupe nga gjashtë nxënës, atëherë do të thotë që janë krijuar tetë grupe debatuese.
<b>Shembull</b>	Tema: Të gjithë studentët duhet të bëjnë punë të përditshme rreth shtëpisë.  Ekipi i parë me tre nxënës duhet të argumentojë në favor të kësaj teme, pra duhet të thotë që të gjithë nxënësit duhet të ndihmojnë rreth punëve të shtëpisë ngaqë bëhen më përgjegjës dhe të disiplinuar. Ndërsa grupi i dytë me tre nxënës duhet të argumentojnë kundër kësaj teme, psh duhet të thotë që nxënësit duhet të fokusohen më shumë në studime dhe angazhime tjera me shkollë ngaqë kjo i bën më të dijshëm dhe më të përgatitur për jetë.
<b>Udhëzimet</b>	Pasi nxënësit ndahen në grupe nga tre, dhe ju caktohet se në cilën anë të debatit do të jenë “pro apo kundër temës”, iu shpërndahet tema për të cilën do të debatojnë; nxënësit nuk mund të zgjedhin se në cilën anë të debatit do të jenë. Nxënësit do të kenë 20 minuta të shkruajnë 2 deri 3 argumente me nga një shembull që e mbështet argumentin e tyre. Pastaj, një përfaqësues i grupit të parë i prezenton argumentet dhe shembujt, dhe pasi i përfundon, ftohet një përfaqësues i ekipit kundërshtarë të prezentojë argumentet dhe shembujt. Pasi të prezentohen argumentet e të dyja anëve, e gjithë klasa ftohen të parashtrojnë pyetje për argumentet e prezentuara. Pastaj, e njëjta procedurë vazhdohet me grupe tjera. Në fund, e gjithë klasa komenton se cilat argumente ishin më të forta dhe të bazuara në shembuj mbështetës.



### Temat

1. Secili student duhet të luajë një instrument muzikor.
2. Detyrat e shtëpisë duhet të ndalohen.
3. Uniforma shkollore duhet të jenë të detyrueshme.
4. Fëmijët nën moshën 14 vjeç nuk duhet të lejohen në faqet e mediave sociale.
5. Interneti duhet të ndalohet në shkolla.

<b>Titulli</b>	<b>Lojra për trurin</b>
<b>Qëllimi</b>	Lojëra atraktive që e vënë trurin në funksion dhe përmirësojnë kujtesën e nxënësve.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p><i>Loja e parë (15 minuta)</i></p> <p>Të gjithë nxënësit në një fletë të bardhë duhet të vizatojnë nga memoria lagjen e tyre (dyqanet, hyrjet e shtëpive apo ndërtesave, drunjtë, apo çfarëdo objekti që kanë përreth) për rreth 15 minuta. Pastaj, diskutojnë në klasë nëse kishin vështirësi të mbajnë në mend objektet në detaje. Si detyrë, të nesërmen duhet të prezantojnë nëse kanë harruar të përfshijnë diçka në vizatim pasi të analizojnë lagjen.</p> <p><i>Loja e dytë (15 minuta)</i></p> <p>Për të luajtur, nxënësit ndahen në grupe nga pesë deri gjashtë nxënës. Për të filluar, personi i parë thotë, "Unë po shkoj në një udhëtim dhe po sjell ____." Nxënësit duhet të plotësojnë zbrazëtirën me çdo send (fjalë) për të cilin mund të mendojnë. Pastaj personi tjetër do të përsërit fjalinë e tij/saj dhe do të shtojë atë që ai/ajo po sjell. Për shembull, mund të duket kështu: "Unë po shkoj në një udhëtim dhe po sjell valixhen." Nxënësit vazhdojnë ta përsërisin listën dhe të shtojnë: "Unë po shkoj në një udhëtim dhe po sjell valixhen dhe syzet"; "Unë po shkoj në një udhëtim dhe po sjell valixhen, syzet dhe aparatin fotografik". Në momentin që njëri nga nxënësit harron ndonjë fjalë që është me rend, për shembull thotë valixhen dhe aparatin fotografik, por harron syzet, atëherë fillon grupi tjetër.</p> <p>Për të sfiduar nxënësit edhe më tej, ju mund t'i kërkonit atyre të listojnë artikujt sipas rendit alfabetik apo vetëm me shkronja të caktuara. Për shembull, "Unë jam duke shkuar për një udhëtim në plazh dhe po sjell një anije, batanije të plazhit dhe cirkun."</p> <p><i>Loja e tretë (15 minuta)</i></p> <p>Të gjithë nxënësit ulen në rreth dhe marrin nga një objekt ose fotografi nga libri/revista që kanë para (p.sh syzet, lapsin, fotografi nga libri, etj). Të gjithë nxënësit duhet të kenë nga një objekt apo fotografi të ndryshme në dorë. Mësimdhënësi/lehtësuesi fillon një tregim me objektin që ka në dorë, p.sh nëse keni në dorë një unazë atëherë filloni një tregim rreth unazës "Këtë unazë e kam nga stërgjyshja", pastaj vazhdon nxënësi afër duke vazhduar tregimin dhe duke përfshirë objektin që ka në dorë; nëse ka stilolaps, "me këtë stilolaps i shkruaja letra gjyshes sime", e kështu vazhdon me radhë tek të gjithë nxënësit. Pra, tregimi duhet të zhvillohet duke u bazuar në ngjarjen që krijohet nga përfshirja e objekteve që i ka secili.</p>

<b>Titulli</b>	<b>Fakt apo Opinion</b>
<b>Qëllimi</b>	Zhvillimin e shkathtësive për vlerësim ndërmjet fakteve dhe opinioneve; zhvillimin e shkathtësive të mendimit racional dhe logjik.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	Fakt: Një gjë që dihet ose vërtetohet e vërtetë. Opinion: Një pikëpamje ose gjykim i formuar për diçka, jo doemos i bazuar në fakt ose njohuri.
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Nxënësit duhet të dëgjojnë një thënie të lexuar nga mësuesi/lehtësuesi dhe të përcaktojnë nëse është një fakt apo një opinion. Nxënësit mblidhen në mes të klasës dhe nëse është një fakt ata duhet të ecin në pjesën e prapme të dhomës, dhe nëse është një opinion ata duhet të ecin në pjesën e përparme të dhomës. Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme, nxënësit mund të zgjohen nga vendi nëse është fakt, ose të qëndrojnë ulur nëse është opinion.</p> <p>Shembujt të lexohen nga mësuesi/lehtësuesi (7 minuta)</p> <p>Pushimi më i lezetshëm është Nata e Vitit të Ri. <i>Opinion</i></p> <p>Viti i ri fillon me 1 janar. <i>Fakt</i></p> <p>Toka është e elipse. <i>Fakt</i></p> <p>Vera vjen pas pranverës. <i>Fakt</i></p> <p>Prishtina është qyteti më i mirë në Kosovë. <i>Opinion</i></p> <p>Pirja e lëngut të portokallit menjëherë pasi të keni larë dhëmbët, shijon keq. <i>Opinion</i></p> <p>Ka më pak arinj panda në botë sesa arinjtë e thinjur. <i>Fakt</i></p> <p>Mishi i pulës që nuk është përgatitur dhe gatuar siç duhet mund të shkaktojë salmonelën. <i>Fakt</i></p> <p>Pastaj, nxënësit duhet të shkruajnë në çifte, 5 fakte dhe 5 opinione dhe të lexohen në grupe. (17 minuta)</p>

<b>Titulli</b>	<b>11 Fjalë</b>
<b>Qëllimi</b>	Zhvillimin e shkathtësive të mendimit kritik dhe artistik, si dhe aftësive komunikuese
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Nxënësit ndahen në grupe nga pesë ose gjashtë, dhe pastaj ju lexohen këto udhëzime.</p> <p><i>Udhëzime</i></p> <p>Imagjinoni të jetoni në një botë ku ka vetëm dhjetë (10) fjalë që mund t'i përdorni. Ju mund t'i përsërisni sa herë të doni, por nuk mund të përdorni kurrë ndonjë fjalë tjetër.</p> <p>Tani, mendoni për 5 minuta dhe shkruani njëmbëdhjetë (11) fjalët që keni zgjedhur. Mos harroni, ju keni vetëm njëmbëdhjetë (11) fjalë për t'u përdorur, kështu që zgjidhni mirë!</p> <p>Pastaj, shkruani njëmbëdhjetë (11) fjali me kuptime të ndryshme me këto fjalë për 5 minuta.</p> <p>Pasi të keni përfunduar fjalitë, secili nga ju prezantoni tri (3) fjali që i përzgjidhni për të gjithë. Mund të përdorni ndjenjat dhe gjestet që të ju kuptojë grupi më mirë. Grupi mund të përdorë fjalë të ndryshme që të mundohet të ju kuptojë. Pas secilës fjali, tregoni se a e kanë kuptuar qartë grupi fjalitë tuaja (20 minuta).</p> <p>Secili nxënës prezanton para grupit.</p>
<b>Pyetje për diskutim</b>	<p>Për prezantime, pyesni nxënësit (15 minuta):</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Si shkoi aktiviteti?</li> <li>2. Pse i keni përzgjedhur (njëmbëdhjetë) 11 fjalët që i keni përzgjedhur? (Ndërlidhen me jetën e përditshme, ju preokupojnë, përshkruajnë familjen tuaj etj.).</li> <li>3. A kishit vështirësi të komunikoni mesazhin tuaj? Cilën fjalë do ta ndërroni? (Përgjigje: mendime të ndryshme brenda grupit, njohuri të ndryshme, gjykime të ndryshme, e këto ndikojnë në kuptimin e mesazhit).</li> <li>4. A keni përdorur ndonjë strategji në përzgjedhjen e fjalëve? (Përgjigje: Fjalë që kanë më së shumti sinonime dhe mund të përdoren si metafora, pra fjalë që mund të kenë kuptime të shumta, është strategjia e kësaj loje).</li> <li>5. Pas këtij informacioni, identifikoni një fjalë që ka shumë kuptime, dhe cilat janë ato?</li> </ol>

<b>Titulli</b>	<b>Sfidat e zgjidhjes së problemeve</b>
<b>Qëllimi</b>	Zhvillimi i të menduarit abstrakt dhe kompleks (p.sh., shkathtësi të larta intelektuale), që është i nevojshëm për ta njohur botën dhe veten si dhe për zgjidhje të problemeve.
<b>Niveli</b>	Klasa 9, 10, 11, 12
<b>Materialet</b>	<p>Opsioni 1: Aneksi “Matriksa e Zgjidhjes së Problemeve” printohet për secilin nxënës.</p> <p>Opsioni 2: Aneksi “Matriksa e Zgjidhjes së Problemeve” paraqitet në projektor dhe nxënësit e kopjojnë në fletë.</p> <p>Opsioni 3: Aneksi “Matriksa e Zgjidhjes së Problemeve” vizatohet në tabelë dhe nxënësit e kopjojnë në fletë.</p>
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	Nxënësit ndahen në çifte dhe të gjithë duhet të ofrojnë zgjidhje për këtë problem (15 minuta), duke plotësuar fletushkën “Zgjidhja e problemeve”. Tek “Problemi” shkruhet se cili është problemi, tek “Pikëpamje nga pala tjetër” shkruhet se çfarë problemi mund të kenë Zani dhe Anda (p.sh. mungesë në komunikim, ose mungesë te kohës), tek “Opsionet për zgjidhjen e problemit” shkruhen të gjitha opsionet që mund të zgjidhin problemin, dhe pastaj tek “Vlerësimi i opsioneve” shkruhen përparësitë apo të mirat e opsioneve, dhe mangësitë ose argumentet kundër opsioneve (ndikimi negativ që mund të ketë opsioni). <i>P.sh.</i> Opsion mund të jetë që ti tregoni mësimdhënësit – përparësi: përfundoni projektin, mangësi: humbni shoqërinë). Pasi të bëhet vlerësimi i opsioneve, përzgjidhet opsioni me më pak mangësi dhe shkruhet tek “Zgjidhja” dhe pastaj evidentohen hapat konkret se si do të zgjidhet problemi tek “Hapat për zgjidhjen e problemit”.
<b>Udhëzime</b>	<p>Puna në ekip: Jeni në ekip me Zanin dhe Andën për projektin “Ndërmarrësia”. Ju duhet të bëni një hulumtim të tregut për të gjetur biznese fitimprurëse, dhe të shkruani propozimet tuaja në një ese hulumtuese. Keni kontaktuar me Zanin dhe Andën, mirëpo asnjëri nuk po të përgjigjen. Afati i dorëzimit është edhe një javë dhe ende nuk jeni takuar për të punuar në projekt. Si do ta zgjidhni këtë problem? <i>Plotësoni fletushkën “Zgjidhja e problemeve”.</i></p> <p>Pasi të plotësohet fletushka, nxënësit diskutojnë në grupe rreth informatave dhe zgjidhjeve që i kanë shkruar dhe pajtohen në një strukturë të përbashkët në zgjidhjen e problemit (15 minuta).</p> <p>Pasi të dakordohen se si do të zgjidhin problemin, nga një përfaqësues i grupit prezanton planin e grupit dhe hapet diskutim i lirë në klasë.</p>
<b>Udhëzime shitesë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Problemi: shkruhet vetëm problemi i cili është; një problem.</li> <li>2. Pikëpamje nga pala tjetër: shkruhen tre (3) deri katër (4) arsye që mund t'i kenë Zani ose Anda që nuk po punojnë në projekt.</li> <li>3. Opsionet për zgjidhjen e problemit: shkruhen dy (2) deri tre (3) opsione për zgjidhjen e problemit; mënyra apo metoda për zgjidhjen e problemit.</li> </ol>

Në këtë rast, mund të shkruhet – përfundimi i projektit vetëm, injorimi i problemit dhe mos-përfundimi i projektit, dërgimi i një mesazhi tjetër tek Zani dhe Anda etj.

4. Vlerësimi i opsioneve: për secilin opsion shkruhen përparësitë dhe mangësitë, p.sh. Opsioni 1: përfundimi i projektit vetëm mund të ketë përparësi që projekti do të përfundonte, por mangësi që Zani dhe Anda do të bëjnë të njëjtën gjë prapë.

5. Zgjidhja e problemit: këtu përzgjidhet opsioni me më së paku mangësi dhe më së shumti përparësi.

6. Hapat për zgjidhjen e problemit: shkruhen hapat që do të ndërmerren për zgjidhjen e problemit.

Aneks 2

## Matriksa e Zgjidhjes së Problemeve

1. Problemi	2. Vlerësimi i opsioneve
	<i>Pro/Përparësitë</i>
	<i>Kundër/Mangësitë</i>
3. Pikëpamje nga pala tjetër	4. Opsionet për Zgjidhjen e problemit
5. Zgjidhja e problemit	6. Hapat për zgjidhjen e problemit

<b>Titulli</b>	<b>Lumturia dhe Stresi</b>
<b>Qëllimi</b>	Zhvillimi i aftësisë për shfrytëzimin e burimeve të informacionit dhe për qasje kritike ndaj të dhënave të ndryshme.
<b>Niveli</b>	Klasa 9, 10, 11, 12
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	<p>Stresi: një gjendje e tendosjes mendore ose emocionale ose tensioni që vjen nga rrethana të pafavorshme.</p> <p>Mirëqenia: të qenit në gjendje të rehatshme, të shëndetshme ose të lumtur.</p> <p>Shkalla e mirëqenies ose stresit: niveli i mirëqenies ose stresit duke u bazuar në shkallën 1 deri 10, 1-pak deri në 10-shumë.</p>
<b>Materialet</b>	<p>Opsioni 1: Të paraqiten dy grafet në Aneks: Grafet në projektor.</p> <p>Opsioni 2: Të printohet Aneks: Grafet për secilin nxënës.</p> <p>Opsioni 3: Të vizatohen dy grafet në tabelën e zezë.</p>
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Aktiviteti përmban kryesisht analizën e të gjeturave në dy grafet “Mirëqenia” dhe “Stresi” përmes pyetjeve dhe interpretimit kritik të gjeturave. Pastaj, nga nxënësit kërkohet që të japin disa opinione rreth të gjeturave.</p> <p><i>Pjesa e parë: Nxjerrja e të Dhënave</i></p> <p>Në çifte, nxënësit duhet të krijojnë planin se si janë nxjerrë këto të dhëna dhe çfarë pyetje janë bërë.</p> <p>1. Kush është intervistuar; çfarë informacione kemi rreth të intervistuarve? (3 minuta përgatitje për përgjigje, 3 minuta diskutim)</p> <p>Përgjigjet e sakta: Janë intervistuar njerëz nga mosha 18 deri 85 vjeçare. Nuk dihet gjinia, etnia, profesioni, vendlindja apo të dhëna tjera, por vetëm mosha.</p> <p>2. Çfarë pyetje është parashtruar në grafën e parë? (3 minuta përgatitje për përgjigje, 3 minuta diskutim)</p> <p>Përgjigjja e saktë: Nga shkalla 1 deri 10, si e vlerësoni mirëqenien tuaj këto ditë?</p> <p>“Këto ditë” ngaqë na duhen të dhëna momentale nga të intervistuarit rreth mirëqenies së tyre. “Shkalla 1 deri 10” me qëllim të kuantifikimit të mirëqenies, pasi që në statistikë kështu bëhet kodimi i të dhënave që janë vështirë të njehsuara.</p> <p>1-aspak mirë --- 5-mesatarisht mirë --- 10-shkëlqyeshëm</p> <p>3. Çfarë pyetje është parashtruar në grafën e dytë? (3 minuta përgatitje për përgjigje, 3 minuta diskutim)</p> <p>Përgjigjja e saktë: Nga shkalla 1 deri 5, sa keni qenë i/e stresuar këto ditë?</p> <p>4. Pse është pyetja e tillë?</p>



“Këto ditë” ngaqë na duhen të dhëna momentale nga të intervistuarit rreth stresit të tyre.

“Shkalla 1 deri 5” me qëllim të kuantifikimit të stresit, dhe 5 si shkalla më e lartë e stresit.

1-aspak stres --- 3-mesatarisht stres --- 5-tepër stres

*Pjesa e dytë: Interpretimi i të dhënave*

Të gjithë nxënësve ju lejohej të paktën 2 minuta për të analizuar secilën pyetje dhe për të komunikuar me shokun/shoqen e bankës përgjigjen, pastaj ftohen disa nxënës që të japin përgjigjen për gjithë klasën.

1. Cilat moshë e kanë mirëqenien më të lartë?

Përgjigja: 82-85

2. Nga cila moshë fillon të rritet mirëqenia? Nga cila moshë fillon të zvogëlohet mirëqenia?

Përgjigje: Rritet nga moshë 50 deri 85; zvogëlohet nga moshë 38 deri 50.

3. Cilat moshë e kanë stresin më të lartë?

Përgjigja: 22-25

4. Nga cila moshë fillon të rritet stresi?

Përgjigje: Rritet nga moshë 18 deri 25.

5. Kur është stresi më i ulët?

Përgjigja: Moshë 82-85.

*Pjesa e tretë: Analiza e të dhënave*

Të gjithë nxënësit ju përgjigjen pyetjeve më poshtë. Së pari, individualisht secili mendon dhe shkruan mendimet e tyre rreth pyetjes (7 minuta), pastaj diskutohen dhe analizohen përgjigjet në çifte (7 minuta), dhe diskutohen pastaj me gjithë klasën.

1. Çka mund të konkludohet nga grafet?

Përgjigja: Të bëhet ndërlidhja e moshës dhe e mirëqenies dhe stresit, dhe të tregohet që stresi dhe mirëqenia janë në lidhje indirekte njëra me tjetrën në bazë të grafeve. Për shembull, moshat më të vjetra kanë më pak stres dhe mirëqenie më të lartë. Andaj, mund të konkludohet në bazë të grafeve, që njerëzit e stresuar nuk kanë mirëqenie të lartë.

2. A mund të thuhet arsye pse ndodh stresi?

Përgjigja: Vetëm në bazë të grafeve nuk mund të thuhet se përse ndodh stresi. Mirëpo, hulumtuesit bëjnë hulumtime nga burime të besueshme për të gjetur arsye. Nxënësit inkurajohen të gjejnë arsye se përse rritet stresi gjatë moshës 22-25 vjeçare, dhe përse rritet mirëqenia gjatë moshës 82-85 vjeçare.


Detyrë: Nxënësit inkurajohen të hulumtojnë në internet dhe të gjejnë burime të besueshme rreth mirëqenies dhe stresit, të gjejnë përgjigje të sakta rreth të gjeturave në grafe.

**Koment**


Ky aktivitet është bazuar dhe është hartuar bazuar në pyetjet që përfshihen në testin PISA.

## Grafet

Mirëqenia (kënaqësia në jetë)



Stresi



<b>Titulli</b>	<b>Analiza e Jetës</b>
<b>Qëllimi</b>	Zhvillimi i të menduarit abstrakt dhe kompleks (p.sh., shkathtësi të larta intelektuale), që është i nevojshëm për ta njohur botën dhe veten si dhe për zgjidhje të problemeve.
<b>Niveli</b>	Klasa 11, 12
<b>Materialet</b>	<p>Opsioni 1: Aneksi “SWOT Analiza” printohet për secilin nxënës.</p> <p>Opsioni 2: Aneksi “SWOT Analiza” paraqitet në projektor dhe nxënësit e kopjojnë në fletë.</p> <p>Opsioni 3: Aneksi “SWOT Analiza” vizatohet në tabelë dhe nxënësit e kopjojnë në fletë.</p>
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	Nxënësit individualisht plotësojnë SWOT analizën për dilemën e mëposhtme për 25 minuta, dhe pastaj bëhet diskutim me të gjithë klasën rreth analizave të tyre.
<b>Udhëzime</b>	<p>Financat: Pasi të përfundoni shkollën e mesme, ju i keni dy mundësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të vazhdoni fakultetin e teknologjisë informative duke punuar vetëm gjysmë orari. Paratë që do ti keni për muaj janë 300 euro, dhe kaq i keni edhe shpenzimet. Pra, do të thotë që ju vazhdoni fakultetin por nuk mund të kurseni asgjë. Nëse e përfundoni fakultetin pas tre vitesh, ju do të punësoheni në një kompani dhe do të paguheni 700 euro në muaj.</li> <li>2. Të mos vazhdoni fakultetin por të punoni me orar të plotë dhe të merrni rrogën 600 euro. Shpenzimet i keni 300 euro, dhe do të kurseni 300 euro në muaj. Me paratë që i kurseni ju do të keni mundësi të investoni, të udhëtoni, të jetoni vetëm.</li> </ol> <p>1. Cilin opsion do të zgjidhni? <i>Plotësoni fletushkën “SWOT Analiza” për të dy opsionet.</i></p>

## SWOT Analiza

S – (Eng. Strength) Përparësitë - këtu shkruani se cilat janë përparësitë e opsionit të parë ose të dytë

W – (Eng. Weakness) Mangësitë - këtu shkruani se cilat janë mangësitë e opsionit të parë ose të dytë

O – (Eng. Opportunities) Mundësitë - këtu shkruani se cilat janë mundësitë nëse zgjidhni opsionin e parë ose të dytë

T – (Eng. Threats) Rreziqet - këtu shkruani se cilat janë rreziqet nëse zgjidhni opsionin e parë ose të dytë

Përparësitë	Mangësitë
Mundësitë	Rreziqet

## **Aftësitë Emocionale**

Kapitulli “Aftësië Emocionale” përfshin aktivitete për zhvillimin e aftësive emocionale dhe shoqërore. Aftësitë emocionale janë njohuritë, qëndrimet dhe aftësitë e nevojshme që nxënësit të njohin dhe kontrollojnë emocionet dhe sjelljet e tyre; krijojnë dhe mbajnë marrëdhënie pozitive; të marrin vendime të përgjegjshme dhe të zgjidhin situata sfiduese; të vendosin dhe të arrijnë synime pozitive.

Aktivitetet në këtë kapitull kanë për qëllim zhvillimin e këtyre aftësive emocionale:

- Gjithëpërfshirjen
- Empatinë
- Etikën
- Ndalimin e paragjytimeve
- Njohjen e vetvetes
- Menaxhimin e ndjenjave dhe emocioneve
- Zgjidhjen e konflikteve ndërmjet ndërmjetësimit.

Përmes këtyre aktiviteteve synohet arritja e qëllimeve dhe shkallëve të aftësisë të paraqitura në Kurrikulën Bërthamë të Kosovës dhe në Kornizën e Re të Kurrikulës së Kosovës. Secili aktivitet përmbanë (1) Qëllimin; (2) Definicionet dhe Fjalët kyçe; (3) Materialet dhe opsione zëvendësuese të materialeve; (4) Përshkrimin e aktivitetit (Udhëzime, Pyetje dhe Përgjigje), si dhe disa kanë si opsionale (5) Detyra shtesë për shtëpi.

Aktivitetet e paraqitura për zhvillimin emocional, përveç se zhvillojnë aftësitë emocionale, gjithashtu përmbajnë tema të ndërlidhura me aftësitë kognitive dhe punën praktike. Secili aktivitet ka anekse të bashkëngjitura, por mësimitdhënësi/ja/lehtësuesi/ja ka mundësinë të ndërrojë disa prej tyre varësisht nga aktiviteti, përderisa i përmbahet qëllimit dhe përshkrimit të aktivitetit.

Aktivitetet janë të ndara sipas niveleve klasore dhe janë kryesisht të përshtatshme për të gjitha nivelet. Natyrisht, niveli i diskutimit dhe parashtrimin të pyetjeve duhet të përshtatet nga mësimitdhënësi duke u bazuar në nivelin klasor.

<b>Titulli</b>	<b>Kur unë jam ti</b>
<b>Qëllimi</b>	Për të provuar efektet e përfshirjes dhe përjashtimit në një grup të caktuar.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	Etiketim: Një frazë ose emër klasifikues i aplikuar për një person ose send, veçanërisht një emër që është i pasaktë ose kufizues. Gjithë-përfshirje: Akti i përfshirjes së të gjithëve në një grup pa marrë parasysh dallimet individuale.
<b>Materialet</b>	Letra të vogla ngjitëse, ose letër e thjeshtë dhe një ngjitës – nga një letër për secilin nxënës të cilat do të shërbejnë si etiketa për tu ngjitur në ballë të secilit. Në këto letra shkruani “Më përshëndet”; “Më duartrokit”; “Më buzëqesh”; “Më thuaj jam njëshi”; “Më komplimento këpucët”; dhe rreth 20% të letrave shkruani “Largohu nga unë”.  Nëse i keni 30 nxënës, i shkruani nga pesë herë të gjitha thëniet; do të thotë, “Më përshëndet” e shkruani në pesë letra, “Më duartrokit” e shkruani në pesë letra, e kështu me radhë.
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	Filloni mësimin duke i pyetur nxënësit nëse ata mendojnë se ne ndonjëherë etiketojmë njerëz sepse ata i përkasin grupeve të ndryshme. Thuajani atyre se etiketat që u vendosim njerëzve shpesh kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në grupe.  U thoni nxënësve që do t'u jepni secilit një etiketë. Thuajuni se do ta vendosni në ballin e tyre, në mënyrë që ata të mos shohin se çfarë thotë. Shpërndani etiketat në mënyrë të rastësishme. Kërkojuni të gjithëve të qëndrojnë të qetë dhe të mos i zbulojnë njëri-tjetrit se çfarë thonë etiketat e tyre.  Kur të gjithë kanë një etiketë, kërkojuni nxënësve të ngrihen dhe të ecin vërdallë sikur të ishin në një festë apo në oborrin e shkollës. Kujtojuni atyre se ata nuk duhet të zbulojnë atë që është në etiketën e askujt tjetër. Lëri studentët të shoqërohen me njëri tjetrin dhe të ecin vërdallë në klasë për 4 deri në 5 minuta, pastaj kërkonit që ata të kthehen në vendet e tyre pa shikuar etiketat e tyre.
<b>Diskutim</b>	Parashtroni pyetjet e mëposhtme për gjithë klasën: Si po ndiheshit? Pa e shikuar etiketën tuaj, a e dini se çfarë thotë? Si e dini? Të gjithë ju që mendoni se keni etiketën "Largohu nga unë", ju lutemi e jani të qëndroni së bashku para klasës. Si u ndjetë?  Lejoni nxënësit të shikojnë etiketat e tyre tani. Shpjegoni se të gjithë kemi përjetuar kohë kur kemi ndjerë sikur të kemi veshur një etiketë "Largohu nga unë" - kur ndiheshim të lënë jashtë një grupi. Sidoqoftë, disa grupe e

provojnë këtë më shumë se të tjerët, madje rregullisht. Pastaj i pyesni:

Cilat janë disa grupe në shkollën tonë që shënjestrohen ose lihen jashtë?

Cilat grupe në shoqëri duket se kanë një etiketë "Largohu nga unë"? (Disa shembuj përfshijnë njerëz me aftësi të kufizuara, njerëz të një feje të ndryshme, njerëz të një race tjetër, njerëz që nuk i kanë kushtet e mira ekonomike, njerëz që vijnë nga fshatrat.)

Kujtojeni atyre se askush nuk ju tha asgjë negative atyre; ishte thjesht në komunikimin tonë jo-verbal - gjuhën tonë të trupit dhe shprehjet tona. Pa fjalë, ata morën mesazhin. Theksoni se 94 përqind e të gjithë komunikimit është jo-verbal. Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje të madhe gjuhës sonë të trupit dhe shprehjeve jo-verbale, si dhe fjalëve tona.

Përfundoni me pyetjet shtesë vijuese:

Çfarë mund të bëjmë për të ndryshuar sjelljen tonë jo-verbale për t'i ndihmuar të gjithë të ndjehen të përfshirë?

Çfarë bëjnë ndonjëherë njerëzit nga grupet që kanë mbetur jashtë apo përjashtohen? (Ndonjëherë ata mblidhen dhe formojnë grupet e tyre dhe izoloohen; ndoshta kjo ka ndodhur gjatë këtij aktiviteti.)

Ndonjë mendim shtesë përse anëtarët e grupeve të përjashtuar veprojnë në shoqëri ashtu si veprojnë?

A ka ndonjë koment shtesë së çfarë ndjenje është të jesh në një grup të shtypur dhe të përjashtuar?

Nëse mjafton koha, kërkoni nga të gjithë nxënësit të krijojnë 5 deri në 6 rregulla për klasë rreth përfshirjes së të gjithë nxënësve. Pasi të shkruhen rregullat në grupe, të komentohen nga e gjithë klasa dhe rregullat i shkruani në një poster/pankartë dhe i vendosni në klasë.

<b>Titulli</b>	<b>Unë nuk kam sa ke ti</b>
<b>Qëllimi</b>	Kuptimi i ndikimit të kushteve të ndryshme financiare në qasje për mundësi të barabarta.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Materialet</b>	<p>Materiale për vizatim dhe ngjyrosje: lapsa, lapsa me ngjyrë, gërshërë, markerë, fleta A4 ose A5, lapsa shkëlqyes, letra me ngjyra.</p> <p>Opsioni 1: Nëse shkolla apo mësimdhënësi nuk kanë mundësi të gjejnë këto materiale, kërkohet nga nxënësit ti sjellin tek mësimdhënësi çfarëdo materiale për vizatim që kanë me vete.</p> <p>Qëllimi i aktivitetit është të bëhet shpërndarja e pabarabartë e mjeteve të punës për vizatim, andaj grumbulloni çfarëdo materiali që keni që mund të përdoret për vizatim.</p>
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Ndani nxënësit në pesë grupe me numër të barabartë të nxënësve.</p> <p>Shpërndani mjetet e punës për secilin grup para klasës, e gjithë klasa duhet të shohë se çfarë materiale po ju ofroni secilit grup.</p> <p>Grupi i parë: Një fletë vizatimi, një laps, dhe një laps me ngjyrë.</p> <p>Grupi i dytë: Një fletë vizatimi, dy lapsa, dhe disa lapsa me ngjyrë.</p> <p>Grupi i tretë dhe i katërt: Një fletë vizatimi, dy lapsa, disa lapsa me ngjyrë, gërshërë, letra me ngjyrë, markerë me ngjyra, ngjitës.</p> <p>Grupi i pestë: Një fletë vizatimi, dy lapsa, disa lapsa me ngjyrë, gërshërë, letra me ngjyrë, markerë me ngjyra, ngjitës, lapsa shkëlqyes, vizore, dhe çfarëdo materiali tjetër që keni.</p> <p>Grupet duhet të vizatojnë dhe të krijojnë artistikisht “Një ditë pranvere”; të gjitha grupet duhet të punojnë në temën e njëjtë. Ata mund të përdorin vetëm materialet e dhëna grupit të tyre; ata nuk mund të huazojnë materiale nga grupe të tjera. Nëse nxënësit pyesin pse përmbajtja e materialeve është e ndryshme, thjesht thoni që këto janë materialet në dispozicion për grupin tuaj. Thuajuni atyre se posterat e tyre të përfunduar do të prezantohen para klasës dhe se do të kenë 15 ose 20 minuta për të përfunduar posterat e tyre.</p> <p>Pasi të kalon koha, ftoni të gjithë nxënësit të kthejnë materialet dhe të dalin një nga një të prezantojnë posterët e grupit.</p>
<b>Diskutim</b>	<p>Si u ndjetë kur vutë re se disa nxënës kishin më shumë materiale sesa ju?</p> <p>Si u ndjetë kur vutë re se disa grupe kishin më pak materiale sesa ju?</p> <p>Në cilat mënyra ndikuan materialet që kishit në projektin tuaj?</p>



Si do të ishit ndjerë nëse unë do të kisha gjykuar këto posteret tuaja finale për një çmim ose për një notë? A do të ishte e drejtë? Pse po ose pse jo?

Nëse njerëzit e tjerë do të shihnin posterat tuaj dhe do t'ju kërkohej të zgjidhnin studentët më të talentuar në dhomë, kë do ta zgjidhnin? A do të ishin këto postera domosdoshmërisht një vlerësim i drejtë i asaj që mund të bëni të gjithë?

Pse mendoni se e bëra këtë aktivitet në këtë mënyrë?

Në cilat situata të tjera njerëzit kanë përparësi ndaj të tjerëve? (Jepni disa shembuj për të nxitur klasën – kompjuterë të shtrenjtë për kodim apo dizajn, piano në shtëpi për muzikë etj.)

A është e rëndësishme të merren parasysh rrethanat dhe mundësitë individuale përpara se të gjykoni aftësitë e një personi? Pse po ose pse jo?

<b>Titulli</b>	<b>Kur ti je unë</b>
<b>Qëllimi</b>	Për të përjetuar një gjendje të ngjashme me atë që disa nxënës me aftësi të kufizuara të mësimi i ndjejnë rregullisht.
<b>Niveli</b>	Klasa 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	<p>Nxënësit me vështirësi në të nxënë: Një gjendje mendore që krijon vështirësi në përvetësimin e njohurive dhe aftësive në nivelin e pritur të nxënësve të së njëjtës moshë, veçanërisht kur nuk shoqërohet me një aftësi të kufizuar fizike.</p> <p>Disleksia: Një term i përgjithshëm për çrregullime që përfshijnë vështirësi në të mësuarit për të lexuar ose interpretuar fjalë, shkronja dhe simbole të tjera, por që nuk ndikojnë në inteligjencën e përgjithshme.</p> <p>Spektri i Autizmit: Një çrregullim zhvillimor që karakterizohet me vështirësi në bashkëveprimin dhe komunikimin shoqëror, dhe nga modele të kufizuara ose të përsëritura të mendimit dhe sjelljes</p>
<b>Materialet</b>	<p>Opsioni 1: Aneksi 1 i printuar për nxënës.</p> <p>Opsioni 2: Paraqitja e tekstit në projektor.</p> <p>Opsioni 3: Leximi i tekstit direkt nga manuali fjali për fjali nga nxënës të ndryshëm.</p>
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p><i>Pjesa e Parë – 15 minuta</i></p> <p>Hapni diskutimin duke pyetur të gjithë nxënësit:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kush nga ju ka problem të koncentroheshi shumë gjatë kur jeni duke lexuar një lekturë, ngriteni dorën?</li> <li>2. Kush nga ju ka problem të mbajë në mend formulat apo vjershat, ngriteni dorën?</li> <li>3. Përmendni tri gjëra që ju bëjnë të humbi fokusin.</li> </ol> <p>(Përgjigje të mundshme: televizori, telefoni, motra e vogël, zhurma e automobilave).</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>4. A bëni ndonjë gjë që jo domosdoshmërisht e bën edhe dikush tjetër? (p.sh. i numëroni hapat deri në shkollë, nuk vishni ngjyrën e kuqe ditën e mërkurë, i mblidhni numrat që janë në targa të veturave, numëroni veturat e bardha etj.).</li> </ol> <p>Qëllimi i këtyre pyetjeve: nxënësit kuptojnë që të gjithë jemi të veçantë dhe përballemi pak a shumë me të njëjtat sfida.</p> <p>Pas diskutimit, kërkoni që nxënësit vullnetarë të lexojnë fletën Aneksi 1 me zë të lartë në seksione të vogla. Pasi nxënësit të kenë shumë të vështirë të lexojnë, lexoni fragmentet nga fleta e përgjigjeve.</p>

### Diskutim

Pyetni nxënësit që u përpoqën ta lexonin se si u ndjenë?

U thoni nxënësve se ky është një shembull i asaj që si leximi mund të jetë për nxënësit që kanë nevoja të veçanta në të nxënë, ky është një shembull i dileksisë. Njerëzit që kanë nevoja të veçanta në të nxënë mund të kenë ndjenja të ngjashme me ato që keni përjetuar.

Informoni nxënësit që ekspertët vlerësojnë se 6-10 përqind e moshatarëve të tyre në botë kanë nevoja të veçanta në të nxënë. Për njerëzit me aftësi të kufizuara në të nxënë, leximi mund të jetë veçanërisht i vështirë, por kjo nuk ndikon në inteligjencën e tyre. Njerëzit me nevoja të veçanta në të nxënë kanë inteligjencë mesatare ose mbi mesatare.

### *Pjesa e dytë – 10 minuta*

Pyetni nxënësit se cili nga njerëzit e mëposhtëm ka / ose ka pasur një nevojë të veçantë në të nxënë:

Tom Cruise (Tom Kruz)

Walt Disney (Ualt Dizni)

Albert Einstein (Albert Ajnshtajn)

Pasi të hamendësojnë, lexoni përshkrimin e secilit prej këtyre njerëzve. Theksoni që të gjithë këta njerëz ishin shumë të suksesshëm përkundër nevojave të veçanta në të nxënë.

Të famshëm me aftësi të kufizuara

Tom Cruise

Ai është një yll i famshëm i filmit. Ai mëson tekstin për filma duke dëgjuar një kasetë sepse vuan nga disleksia.

Walt Disney

Ai ishte i ngadaltë në detyrat shkollore dhe nuk kishte një përvojë të suksesshme shkollore, por më vonë u bë një producent dhe karikaturist i njohur i filmit.

Albert Einstein

Si fëmijë, ai nuk mund të fliste deri në moshën tre (3) vjeç. Ai nuk mësoi të lexonte derisa ishte nëntë (9) vjeç. Mësuesit e tij e konsideruan atë si mentalisht të ngadaltë, i pashoqërueshëm dhe ëndërrimtar. Ai dështoi provimin pranues për kolegji. Por në fund, ai zhvilloi Teorinë e Relativitetit.

### *Pjesa e tretë – 20 minuta*

Lëshoni këtë video në klasë: [youtube.com/watch?v=6fy7qUlp8Ms](https://youtube.com/watch?v=6fy7qUlp8Ms) (shihni përkthimin në aneks dy) dhe lexoni përkthimin fjali për fjali. Komentoni me nxënësit se çfarë mendojnë rreth kësaj videoje. Nëse nuk keni projektor

	<p>apo internet, dërgojani këtë video prindërve apo nxënësve një ditë më parë bashkë me përkthim, dhe pastaj e komentoni.</p> <p>Diskutim</p> <p>A duhet t'i gjykojmë njerëzit bazuar në aftësitë e tyre të mësimi?</p> <p>A munden njerëzit me aftësi të kufizuara në të nxënë të japin kontribute të rëndësishme për shoqërinë?</p> <p>Si mund të ju ndihmojmë shokëve dhe shoqeve me aftësi të kufizuara?</p>
<b>Koment</b>	<p>Nëse keni nxënës me nevoja të veçanta, bëni kujdes tek formulimi i pyetjeve dhe zhvillimit të aktivitetit, në mënyrë që mos të krijohet pakënaqësi në klasë. Gjithnjë ju referoheni pyetjeve tek pjesa e parë që të bëni të gjithë fëmijët të ndjehen pjesë e grupit, pra që të gjithë i kanë pak a shumë të njëjtat vështirësi.</p>

Aneks 1: Leximi

# L E X I M I

Është vështirë të mësoj të lexoj kur shkronjat nuk rrijnë në një vend. A mund të imagjinoj se si është të lexosh kur fjalët dhe shkronjat lëvizin poshtë e lartë? Leximi nuk është aktiviteti im i preferuar shkollor. Më ndihmon të përdor gishtin ose një vizore që të di se ku jam duke lexuar që të mund të lexoj.

## Leximi

Është vështirë të mësoj të lexoj kur shkronjat nuk rrijnë në një vend. A mund të imagjinoj se si është të lexosh kur fjalët dhe shkronjat lëvizin poshtë e lartë? Leximi nuk është aktiviteti im i preferuar shkollor.

Më ndihmon të përdor gishtin ose një vizore që të di se ku jam duke lexuar që të mund të lexoj.

### Aneks 2: Autizmi

Të gjithë dallojmë nga njëri tjetri. Dhe kjo është një mrekulli.

Disa nga këto dallime është më lehtë të shihen: gjatësia, modeli i flokëve, gjinia, ngjyra e syve e kështu me rradhë.

Disa dallime tjera nuk mund të shihen: ushqimi jonë i preferuar, frika, ose aftësitë e veçanta.

Interesant, mënyra se si e shohim botën është gjithashtu ndryshe.

Për shembull, çka shihni në këtë vizatim?

Shumica e njerëzve e shohin një patë, por disa nga ju mund të keni parë një lepur. Cilëndo që e keni parë, është e saktë. Ky është vetëm një vizatim për të treguar që të gjitha mendjet punojnë ndryshe.

Truri është kompjuteri i trupit tuaj, punon ndryshe për secilin prej nesh, dhe kontrollon: se si mësoni, prandaj ne jemi të shkëlqyeshëm në gjëra të ndryshme,

se si ndiheni, prandaj ne ndjejmë emocione të ndryshme,

dhe se si komunikoni.

Ndonjëherë truri është i lidhur në atë mënyrë që i ndikon shqisat dhe se si i përceptojmë dhe lexojmë situatat dhe bashkëveprimet. Kjo njihet si autizëm.

Shumë njerëz kanë autizëm kështuqë është shumë e mundur që ju njihni dikë që është autist dhe për këtë arsye është e nevojshme të dini pak rreth autizmit.

Lidhja speciale brenda një truri autist ndonjëherë mund ta bëjë një person të shkëlqyeshëm në detyra që për ne janë të vështira, si për shembull: matematika, vizatimi ose muzika.

Por mund ta bëjë edhe të kundërtën, dhe aktivitetet që për ne janë shumë të lehta janë jashtëzakonisht të vështira për ta si për shembull: të bëjnë shokë e shoqe.

Shqisat dërgojnë rregullisht mesazhe tek truri juaj rreth rrethinës suaj dhe njerëzit tjerë. Mirëpo, kur truri i një personi dhe shqisat e tyre nuk komunikojnë mirë, truri mund të bëhet i tronditur dhe i hutuar, dhe kjo ndikon se si e shohin botën.

Imagjinoni sikur jeni duke ecur rrugës.

Kështu do të mund ta ketë përjetuar një autist ecjen e njejtë.

E frikshme, apo jo?

Fatkeqësisht, në shumë raste personi autist nuk mund të thotë se si po ndihet. Pra, edhe pse është kaos në mendjen e tyre, ata duket që janë në rregull nga jashtë, në pamundësi për të kërkuar ndihmë.

Ne të gjithë zhvillojmë sjellje të ndryshme për të na ndihmuar të qetësohemi gjatë situatave të pakëndshme: mund të shikojmë anash, të përqafojmë veten, të grimcojmë thonjtë, të kafshojmë buzën e kështu me rradhë.

Njejtë, autistët zhvillojnë sjellje të ndryshme për të përballuar këto momente të vështira. Këto veprime mund të duken të pazakonta por kjo është mënyra e tyre për tu qetësuar. Kur kjo ndodh, do të thotë që janë duke kaluar në një kohë të vështirë. Gjëja e duhur për të bërë është që mos të ja bëni këtë kohë edhe më të vështirë duke u bërë nervoz, duke i injoruar ose duke i ngacmuar.

Mbani mend, vetëm pse një Playstation nuk mundet të lexojë një lojë Xbox, nuk do të thotë që është dëmtuar.

Njerëzit me autizëm kanë nevojë për shoqëri që është e gatshme të gjejnë kohën për ti njohur. Me komunikim të duhur dhe shumë durim, të gjithë do të jenë më mirë.

Njerëzit me autizëm nuk janë të sëmurë ose të dëmtuar, ata thjeshtë kanë një pikëpamje të ndryshme për botën dhe me pak mbështetje nga shokët e shoqet, ata do të mund të ndajnë këtë pikëpamje me ne.

Autizmi mund të krijojë mrekulli.

<b>Titulli</b>	<b>Varka e shpëtimit</b>
<b>Qëllimi</b>	Kuptimi dhe qasja kritike ndaj dilemave etike në shoqëri, dhe zhvillimi i vendimmarrjes në situata etike.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	<p>Etika: Parime morale që rregullojnë sjelljen e një personi ose kryerjen e një veprimtarie.</p> <p>Dilema Etike: Një problem i vendimmarrjes ndërmjet dy situatave morale, asnjë prej të cilave nuk është krejtësisht e pranueshme ose preferuese</p> <p>Morali: Standardet e sjelljes ose bindjet e një personi në lidhje me atë që është dhe nuk është e pranueshme që ata të bëjnë</p>
<b>Materialet</b>	1. Teksti i mëposhtëm të paraqitet në projektor ose të shkruhet në tabelë.
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	Ndani nxënësit në grupe nga pesë ose gjashtë nxënës. Lexoni me zë tekstin nga tabela ose projektori. Skenarin e gjeni në faqen 34 që ta paraqitni në klasë.
<b>Pjesa e parë 20 minuta</b>	<p><i>Diskutoni për skenarin e mëposhtëm dhe merrni një vendim si grup. Dikush duhet të jetë i përgatitur të shpjegojë se si e keni arritur vendimin tuaj. Për klasat 6, dhe 7, mund të zhvillohet vetëm pjesa e parë, pra kanë më shumë kohë për diskutim dhe prezantim.</i></p> <p>Anija po fundoset dhe detet janë të furishme. Gjithçka përveç një varkë shpëtimi u shkatërruan. Varka e shpëtimit mban një maksimum prej gjashtë personash. Në anije janë dhjetë njerëz që duan të hipin në varkën e shpëtimit. Katër individët që nuk hipin në barkë me siguri do të vdesin.</p> <p>Kë do të shpëtoni dhe ta lejoni të hipë në varkën e shpëtimit?</p> <p>Një grua që mendon se është gjashtë javë shtatzënë</p> <p>Roje plazhi</p> <p>Dy të rritur të rinj që u martuan kohët e fundit</p> <p>Qytetar i moshuar që ka pesëmbëdhjetë nipër e mbesa</p> <p>Mësuesi i shkollës fillore</p> <p>Binjakë trembëdhjetë vjeç</p> <p>Infermier veteran</p> <p>Kapiteni i anijes</p> <p>Nxënësit diskutojnë në grupe se kënd do ta shpëtojnë për 15 minuta, dhe pastaj një përfaqësues i grupit prezanton se kë do të shpëtojnë dhe arsyet pse.</p>
<b>Pjesa e dytë</b>	Pasi të prezantojnë të gjithë grupet, <i>klasa 8 deri 12</i> , tani i caktoni detyra etike secilit grup për përzgjedhjen e të shpëtuarve në bazë të qëllimi të



### 25 minuta

tyre etik.

Grupi 1 dhe 2: Morali - Çdo jetë ka vlerë, të shpëtuarit duhet të caktohen në mënyrë të barabartë.

Grupi 2 dhe 3: Rezultatet – të shpëtuarit caktohen në bazë të përfitimeve në shoqëri që do të jenë nëse ata shpëtohen.

Grupi 4 dhe 5: Kujdesi – të shpëtuarit përzgjidhen sipas statusit të tyre, pra ata që janë më të ndejshmit në shoqëri: p.sh. barazia gjinore, më të moshuarit etj.

Grupet e mbetura: Principet – të shpëtuarit përzgjidhen duke u bazuar në tri principet: morali, rezultatet dhe kujdesi.

Nxënësit diskutojnë në grupe se kënd do ta shpëtojnë për 15 minuta, dhe pastaj një përfaqësues i grupit prezanton se kë do të shpëtojnë dhe si kanë ndryshuar zgjedhjet e tyre pasi kanë marrë një rol të caktuar etik.

Në fund, pyetje për gjithë klasën:

A ndodh diçka e tillë – dilema etike – në jetën reale? A keni ndonjë shembull?

Aneks 3

## **Skenari**

*Diskutoni për skenarin e mëposhtëm dhe merrni një vendim si grup. Dikush duhet të jetë i përgatitur të shpjegojë se si e keni arritur vendimin tuaj.*

Anija po fundoset dhe detet janë të furishme. Gjithçka përveç një varkë shpëtimi u shkatërruan. Varka e shpëtimit mban një maksimum prej gjashtë personash. Në anije janë dhjetë njerëz që duan të hipin në varkën e shpëtimit. Katër individët që nuk hipin në barkë me siguri do të vdesin.

- Kë do të shpëtoni dhe ta lejoni të hipë në varkën e shpëtimit?
- Një grua që mendon se është gjashtë javë shtatzënë
- Roje plazhi
- Dy të rritur të rinj që u martuan kohët e fundit
- Qytetar i moshuar që ka pesëmbëdhjetë nipër e mbesa
- Mësuesi i shkollës fillore
- Binjakë trembëdhjetë vjeç
- Infermier veteran
- Kapiteni i anijes

<b>Titulli</b>	<b>Gjinia tjetër</b>
<b>Qëllimi</b>	Për të zhvilluar qëndrime të shëndosha, të barabarta dhe realiste ndaj gjinisë tjetër.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Ky aktivitet preferohet të jetë si detyrë shtëpie që të bëhet një shkrim sa më i singertë. Por, edhe nëse shkruhet në klasë, mund të ketë sukses nëse nuk lejohet asnjë bisedë gjatë shkrimit.</p> <p><i>Pjesa e parë</i></p> <p>Kërkoni të shkruajnë ndjenjat dhe mendimet e tyre për gjininë "e kundërt".</p> <p>Jepni deri 15 minuta kohë për shkrimin e këtij teksti. Shembull: 7 deri 8 fjali. Nxënësit mund të duan të marrin në konsideratë pyetjet e mëposhtme në esetë e tyre:</p> <p>Në cilat mënyra jeni ndryshe nga studentët e tjerë në klasën tuaj?</p> <p>Si jeni njësoj si studentët e tjerë në klasën tuaj?</p> <p>A është miqësia me gjininë tjetër e ndryshme nga miqësia me të njëjtën gjini? Si dhe pse?</p> <p>A i ndryshoni veprimet dhe aktivitetet tuaja kur jeni në praninë e gjinisë tjetër? Si dhe pse?</p> <p><i>Pjesa e dytë</i></p> <p>Ndani klasën në gjysmë sipas gjinisë; vajzat në një anë dhe djemtë në anën tjetër. Të gjithë nxënësit duhet ti lexojnë esetë e tyre grupit: vajzat për vajza, dhe djemtë për djem. Pasi të lexohen, anëtarët e grupit mund të japin komente në pikët që pajtohen.</p> <p><i>Pjesa e tretë</i></p> <p>Ftoni të gjithë klasën të kthehen në vendet e tyre dhe kërkoni për vullnetarë të lexojnë esetë e tyre tani për gjithë klasë. Të bëhet komentim nga e gjithë klasa pas çdo eseje. Pastaj pyesni të gjithë nxënësit:</p> <p>A ishte diskutimi më ndryshe kur esetë u lexuan për gjithë klasën? Pse po ose pse jo?</p> <p>Pas diskutimit, kërkoni nga nxënësit të japin deklaratat/komente pozitive për gjininë e kundërt dhe i shkruani në tabelë të ndara në dy rreshta: për vajza dhe për djem. Pastaj, kërkoni nga nxënësit të thonë të përbashkëtat në mes të dy gjinive. Në fund, pyesni se cilat nga komentet mund të</p>

	ndërrojnë anën, p.sh. të dalin nga rreshti i djemve të vajzat dhe nga rreshti i vajzave tek djemtë. Këtu qëllim kryesor është të shihet që nuk ka shumë dallime në mes të mirave tek vajzat dhe djemtë.
<b>Titulli</b>	Menaxhimi i stresit
<b>Qëllimi</b>	Zhvillimi i aftësive për menaxhimin e stresit, traumave dhe përzgjedhjen e konfliktet ndër-personale në mënyrë konstruktive.
<b>Niveli</b>	Klasa 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	Stresi: një gjendje e tendosjes mendore ose emocionale ose tensioni që vjen nga rrethana të pafavorshme ose me shumë kërkesa
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Aktiviteti përmban dy pjesë të cilat kanë për qëllim identifikimin e ndjenjave dhe situatave stresuese, dhe metoda të mundshme të menaxhimit të tyre. Është shumë e rëndësishme të krijohet një ambient i sigurt për nxënësit që të mund të shprehen më lehtë; preferohet që nga mësuesi/lehtësuesi të ju thuhet nxënësve:</p> <p>“Këtu jemi në një ambient të sigurt për secilin prej jush. Çfarëdo që komentohet në klasë do të mbetet brenda kësaj klase, dhe nuk do të diskutohet jashtë saj. Nuk ka përgjigje të gabuar apo përgjigje që do të gjykohej. Pres nga secili prej jush të më ndihmoni të krijojmë këtë ambient të sigurt; pra, të respektoni secilin mendim dhe të bashkëndjeni me shokët dhe shoqet tuaja. Fundja, besoj që të gjithë paksa jeni në situatë të njëjta dhe i keni preokupimet e njëjta me njëri tjetrin.”</p>
<b>Pjesa e parë 20 minuta</b>	<p>Qartësoni me nxënësit që stresi është ndjenja e pakëndshme që ju merrni kur jeni i shqetësuar, i frikësuar, i zemëruar, i irrituar ose i mbingarkuar. Stresi shkaktohet nga emocionet, por ndikon edhe në gjendjen shpirtërore dhe trupore. Shumë të rritur mendojnë se adoleshentët nuk kanë stres sepse ata nuk duhet të punojnë dhe mbështesin një familje. Mirëpo, e kanë gabim ngaqë adoleshentët ballafaqohen me shumë momente stresuese të cilat janë të ngjashme në mes të moshatarëve.</p> <p>Pastaj, kërkoni nga secili nxënës të shkruajnë situatat që i bëjnë nervoz apo i stresojnë. Mund të shkruajnë edhe gjërat më të thjeshta si: stresohem kur nuk gjej përgjigjet e sakta të detyrave në matematikë. Pastaj diskutoni me nxënësit se cilat janë momentet më stresuese që i përjetojnë, dhe shkruani në tabelë situatat që përmenden më së shpeshti nga nxënësit.</p> <p>Pastaj i pyesni ata se si e menaxhojnë stresin, apo si do të preferonin ta menaxhonin stresin?</p> <p>Përgjigje të mundshme: ushtrime fizike, dëgjoj muzikë, lexoj një libër,</p>

	<p>fjetja, bëj joga ose meditoj, shkruaj rreth ndjenjave.</p>
<p><b>Pjesa e dytë</b> <b>25 minuta</b></p>	<p>Duke marrë parasysh që ka shumë situata stresuese të cilat nxënësit nuk ndihen rehat ti komentojnë me klasën, preferohet ky aktivitet për lehtësim emocional.</p> <p>Udhëzime për nxënësit</p> <p><i>Deri tash përmendëm disa nga gjërat që ju stresojnë dhe si i menaxhoni. Tani, dua të lëni anash dhe të më përcjellni gjatë leximit:</i></p> <p><i>Mbylli sytë. "Shih" në mendjen tuaj një plazh të bukur. Dielli po shkëlqen ngrohtësisht, filladi që vjen nga deti është i butë dhe i ngrohtë. Imagjinoni se jeni duke ecur zbathur në rërën e ngrohtë, ndjeni se këmbët tuaja fundosen në rërë me secilin hap. Ecni drejt skajit të ujit dhe lëreni ujin të rrokulliset mbi këmbët tuaja. Hidhuni në ujë; uji është i ngrohtë, i butë dhe shumë freskues. Dil nga uji dhe ec tek peshqiri jot i madh i plazhit, shtrihu dhe relaksohu. Pusho për një kohë në gjithë paqen dhe bukurinë që po të rrethojnë. Imagjinoni si duket, si tingëllon, si vie era. Merrni frymë thellë në ajrin e ngrohtë të detit, qëndro aq gjatë sa të duash.</i></p> <p><i>Kur të jeni gati për të ikur, shkoni në buzë të ujit dhe hidhni në ujë çdo gjë që ju ka mërzitur, çdo gjë që dëshironi ta largoni nga jeta juaj, çdo gjë që ju ka trishtuar, gjithçka që ju shqetëson (p.sh. problemet në shtëpi, dhuna në lagjen tuaj, ngacmimet, vdekja e dikujt të dashur, probleme me miqtë). Paramendojeni atë si një shkëmb i madh, zinxhir i rëndë që po ju mundon. Hidhni atë në oqean sa më larg që të keni mundësi. Shikojeni të fundoset dhe të merret nga valët. Kur të përfundoni, gëzohuni që u liruat nga barra, problemi, shqetësimi; pastaj ecni paqësisht përsëri nëpër rërën e ngrohtë dhe pushoni në peshqirin tuaj të plazhit.</i></p> <p>Lejoni kohë që studentët të japin komente dhe të tregojnë se ku shkuan në vendin e tyre imagjinar dhe çfarë ndiejnë për përvojën / teknikën. Kjo mund të bëhet në çifte, grupe të vogla ose me të gjithë klasën.</p> <p>Shembull i pyetjeve udhëzuese:</p> <p>Përshkruani vendin imagjinar.</p> <p>A ndjeheni më të qetë pas këtij ushtrimi?</p> <p>A ka ndodhur diçka në veçanti që doni ta përmendni?</p> <p>Si ishte ndjenja e hedhjes së problemeve në ujë?</p> <p>A është kjo teknikë / ushtrim diçka që mund të bësh në të ardhmen për tu relaksuar?</p>

<b>Titulli</b>	<b>Ndërmjetësimi: Zgjidhja e konflikteve</b>
<b>Qëllimi</b>	Zhvillimin e shkathtësive për komunikim efektiv dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërmjet ndërmjetësimit.
<b>Niveli</b>	Klasa 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	<p>Konflikt: Mosmarrëveshje në mes të dy apo më shumë nxënësve për arsye të ndryshme.</p> <p>Ndërmjetësimi: Procesi i bashkëbisedimit që ndihmon nxënësit në konflikt për zgjidhjen e problemit përmes bashkëpunimit dhe pa forcë.</p> <p>Kompromis: Një marrëveshje ose zgjidhje e një mosmarrëveshje që arrihet nga secila palë duke bërë lëshime.</p>
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>1. Kërkoni që secili nxënës të japë një shembull të një konflikti për të cilin kanë qenë apo dëgjuar. Shkruani shembujt në tabelë. (Mundohuni të regjistroni rreth 20 shembuj).</p> <p>2. Si klasë, kërkoni nga nxënësit të grupojnë konfliktet që janë të ngjashme. Cilat konflikte duket se kanë shkaqe të ngjashme? Si do ta përshkruani secilën kategori? Vëni emra secilës kategori. P.sh. Konflikte rreth mësimi, konflikte rreth shoqërisë, konflikte rreth familjes etj, pastaj i kategorizoni të gjitha konfliktet aty ku takojnë.</p>
<b>Simulimi</b>	<p>Ndani nxënësit në grupe nga tre, dhe kërkoni që secili grup të zgjedhë një konflikt të identifikuar në tabelë. Nxënësit duhet të simulojnë situatën e konfliktit në mes vete.</p> <p><i>Udhëzimet për nxënësit</i></p> <p>Në grupe nga tre nxënës, zgjedhni një konflikt të paraqitur në tabelë nga ushtrimi i mëparshëm. Dy nxënës të grupit do të jenë në konflikt, pra ata që kanë konflikt në mes vete (p.sh. Dy shoqe në konflikt) dhe nxënësi i tretë është ndërmjetësuesi.</p> <p>Të dy palët në konflikt duhet të tregojnë se përse janë në konflikt, dhe ndërmjetësuesi dëgjon me vëmendje dhe ndihmon grupin të kuptojë se ku është konflikti. Pastaj, të tre së bashku japin mënyra të zgjidhjes së konfliktit.</p> <p>Të gjitha grupet duhet të prezantojnë metodat e zgjidhjes së konfliktit që i kanë identifikuar.</p>
<b>20 minuta</b>	
<b>25 minuta</b>	

## Aftësitë Praktike

Kapitulli “Aftësitë praktike” përfshin aktivitete për zhvillimin e aftësive praktike jetësore. Aftësitë praktike përfshijnë aftësitë që nxënësit duhet t’i posedojnë për jetën shoqërore, duke përfshirë aftësitë ndërmarrëse, bamirëse, artistike dhe mjedisore.

Përvetësimi i aftësive praktike jetësore që nga vitet e hershme të shkollimit është i rëndësishëm në zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë. Së pari, nxënësit do të zhvillojnë aftësi për të menaxhuar dhe organizuar, që do të ndikojë dhe në zhvillimin e ndjenjave të përgjegjësisë, pronësisë dhe llogaridhënies. Së dyti, shkolla dhe komuniteti do të përfitojnë nga këto aftësi praktike të zhvilluara nga nxënësit ngaqë do të ngritën ndjenjat e komunitetit, bashkë-ndjesimit dhe bashkëpunimit. Së treti, me zhvillimin e aftësive praktike, zhvillohet një shoqëri e qëndrueshme dhe stabile që ka për bazë mirëqenien e komunitetit.

- Aktivitetet në këtë kapitull kanë për qëllim zhvillimin e këtyre aftësive praktike:
- Ndërmarrësinë, me fokus në ndërmarrësi shoqërore
- Iniciativën mjedisore dhe shoqërore
- Menaxhimin dhe organizimin e aktiviteteve
- Shprehjen e talenteve
- Puna vullnetare.

Përmes këtyre aktiviteteve synohet arritja e qëllimeve dhe shkallëve të aftësisë të paraqitura në Kurrikulën Bërthamë të Kosovës dhe në Kornizën e Re të Kurrikulës së Kosovës. Secili, aktivitet përmban (1) Qëllimin; (2) Definicionet dhe Fjalët kyçe; (3) Materialet dhe opsione zëvendësuese të materialeve; (4) Përshkrimin e aktivitetit (Udhëzime, Pyetje dhe Përgjigje), si dhe disa kanë si opsionale (5) Detyra shtesë për shtëpi.

Aktivitetet e paraqitura për zhvillimin praktik, përveç se zhvillojnë aftësitë praktike, gjithashtu përmbajnë tema të ndërlidhura me aftësitë kognitive dhe aftësitë emocionale – pra aftësitë që janë krijuar deri më tani nga kapitulli i parë dhe i dytë, zbatohen tek puna praktike. Secili aktivitet ka anekse të bashkëngjitura, por mësimdhënësi ka mundësinë të ndërrojë disa prej tyre varësisht nga aktiviteti, përderisa i përmbahet qëllimit dhe përshkrimit të aktivitetit.

Aktivitetet janë të ndara sipas niveleve klasore dhe janë kryesisht të përshtatshme për të gjitha nivelet. Natyrisht, niveli i diskutimit dhe parashtrimit të pyetjeve duhet të përshtatet nga mësimdhënësi duke u bazuar në nivelin klasor.

<b>Titulli</b>	<b>Ndërmarrësia</b>
<b>Qëllimi</b>	Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	Ndërmarrësi: Krijimi i një biznesi me ide të re dhe personale. Ndërmarrësi shoqërore: Krijimi i një biznesi që ka për qëllim zhvillimin e shoqërisë dhe ndihmon grupet në nevojë.
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Nxënësit ftohen të punojnë në grupe, 5 deri 6 nxënës për grup dhe të vijnë me një ide biznesi të cilën mund ta zbatojnë. Ideja duhet të jetë inovative dhe lehtë e realizueshme për moshën e tyre. Secili grup duhet të bëjë një prezantim duke ju përgjigjur pyetjeve më poshtë. Mësimdhënësi lexon pyetjen e parë dhe i lejon nxënësve nga 10 minuta diskutim; pastaj vazhdon me pyetjen e dytë e kështu me radhë.</p> <p>1. BIZNESI: Cilat janë disa ide të biznesit që ju bien në mend? Shkruani të gjitha idetë, pastaj me vota zgjidheni idenë më të mirë.</p> <p><i>Ide shtesë për mësimdhënësin: Qirinjtë me ngjyra, aksesore për fëmijë, shëtitje e qenëve etj. Nxënësit inkurajohen të mendojnë edhe rreth ndërmarrësive shoqërore; p.sh. supermarket shoqëror i cili mbledh ushqimet që nuk mund të shiten në shitore tjera dhe i shet me çmime shumë më të lira dhe paratë i dërgon për bamirësi, mbledhja e librave të përdorur dhe shitja e tyre me çmim më të lirë, ndërtimi i pajisjeve për pastrimin e ujit dhe dërgimi i tyre në vende në zhvillim që nuk kanë qasje në ujë të pijshëm etj.</i></p> <p>2. BURIMET: Çfarë materiale ju duhen të realizoni idenë e zgjedhur?</p> <p>3. KONSUMATORI: Kush do ti blinte produktet tuaja? Kë do ta kishit konsumatorë?</p> <p>4. MARKETINGU: Si do ta shisni produktin tuaj? Çfarë marketingu do të bëni?</p> <p>Pasi të përfundojnë, nxënësit kanë nga 2 minuta të prezantojnë idetë e tyre para klasës me pikat kyçe.</p>
<b>Udhëzime për prezantim</b>	<p>Mendoni që jeni duke ja prezantuar idenë tuaj një grupi që do të ju japë paratë për themelimin e biznesit. Ata nuk i kanë më shumë se 2 minuta kohë, andaj, prezantimi duhet të jetë i shkurtër dhe ti përgjigjet këtyre pyetjeve:</p> <p>1. Cila është ideja e biznesit? Pse është më e mirë se idetë tjera?</p> <p>2. Si do të realizohet?</p>



	<p>3. Cilat janë përfitimet?</p> <p>4. Si mund të financohet një biznes?</p> <p>5. Si mund të aplikohet për fonde?</p> <p>Opsionale: Mësimdhënësi/ja mund të kërkojë nga klasa të votojnë për idenë më të mirë dhe të i inkurajojë në krijimin e biznesit.</p>
<b>Koment</b>	<p>Niveli: X deri XII. Kërkohet që nxënësit e klasës X deri XII të hapin të paktën një biznes, apo të angazhohen në zhvillimin e biznesit në kuadër të lëndëve mësimore në shkolla profesionale.</p>

<b>Titulli</b>	<b>Puna Vullnetare</b>
<b>Qëllimi</b>	Ngritja e vetëdijës së nxënësve për të kontribuar në shoqëri.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	Vullnetar: Një person që kryen një shërbim me dëshirë dhe pa pagesë.
<b>Materialet</b>	Varësisht nga përzgjedhja e punës vullnetare.
<b>Kohëzgjatja</b>	90 minuta: 45 minuta planifikim; 45 minuta prezantim dhe fillim i punës vullnetare
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>  <i>Pjesa e parë</i> <b>Planifikimi dhe ndarja e roleve</b> <b>45 minuta</b>	<p>Njoftoni nxënësit rreth punës vullnetare dhe dobisë që ka në shoqërinë tonë. Tregoni atyre që ka punë të ndryshme vullnetare që ju përshtaten të gjitha moshave. Pyesni nxënësit të tregojnë shembuj të punës vullnetare dhe shkruani në tabelë. Disa nga punët vullnetare, nëse nuk përmenden nga nxënësit, shënohen në tabelë (15 minuta):</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vizita e shtëpisë së moshuarve një herë në muaj;</li> <li>2. Mbledhja e rrobave për familjet në nevojë dhe shpërndarja e tyre;</li> <li>3. Dhurata, letra të shkruara apo vizita për fëmijë në SOS fshatin;</li> <li>4. Angazhim në aktivitete komunitare, shkollore, dhe jo-fitimprurëse</li> <li>5. Mentorim ndaj më të vegjëlve dhe bashkëmoshatarëve duke përfshirë: orë leximi, klasë mësimi për gjuhë të huaja, shkenca ekzakte, klube të ndryshme të sportit, artit, letrare etj.</li> <li>6. Punë të vogla fizike: mbjellje e luleve dhe pemëve, grumbullim i mbeturinave në oborr të shkollës apo lagje,</li> <li>7. Përgatitje e ushqimeve dhe shpërndarja e tyre tek të pastrehët</li> <li>8. Kujdes ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta brenda shkollës apo lagjes</li> </ol> <p>Pasi ti shtoni edhe këto punë vullnetare, kërkoni nga nxënësit të zgjedhin se në cilin aktivitet dëshirojnë të jenë vullnetarë. Kërkoni nga nxënësit të grupohen në bazë të zgjedhjes së tyre; pra, grupi që përzgjedh vizitë në shtëpinë e të moshuarve bëhen bashkë, ata që zgjedhin mbledhjen e rrobave bëhen bashkë në grup, e kështu me radhë. Pasi të vendosen në grupe sipas preferencave, kërkoni nga nxënësit (15 minuta):</p> <p>Të identifikojnë dhe të shkruajnë të gjitha aktivitetet që duhet të bëhen me radhë për të qenë puna vullnetare e suksesshme;</p> <p>Të caktojnë rolet dhe përgjegjësitë e secilit;</p> <p>Të shkruajnë në detaje se si do të organizojnë punën vullnetare.</p> <p>Pasi të përfundojnë planifikimin, kërkoni nga secili grup të plotësojnë dhe prezantojnë planin e tyre të punës (Aneksi “Plani i Punës” në faqe 47).</p>

	<p>Pas çdo prezentimi inkurajoni nxënësit të japin këshilla dhe sugjerime për grupin rreth punës së tyre. Pasi të kenë caktuar të gjitha grupet aktivitetin, dhe rolet dhe përgjegjësitë, inkurajoni ata të fillojnë me punë: p.sh. të mbledhen një herë në javë që të punojnë në aktivitetin e tyre (15 minuta me mundësi vazhdimi si detyrë shtëpie).</p>
<p><b>Pjesa e dytë</b> <b>Zbatimi dhe</b> <b>prezentimi</b> <b>45 minuta</b></p>	<p>Caktoni një datë që aktiviteti vullnetarë duhet të përfundohet – preferohet të ju lejohet rreth 1 muaj kohë për dizajn dhe zbatim të aktivitetit. Secili grup duhet të bëjë punën vullnetare të përzgjedhur brenda një muaji. Mësimdhënësi/Lehtësuesi duhet të ndjek punën e nxënësve gjatë gjithë kohës.</p> <p>Pas një muaji, kërkoni nga secili grup të bëjnë një prezentim rreth punës së tyre dhe kërkoni të bëjnë fotografi gjatë gjithë procesit:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Dizajni i aktivitetit: organizimi, ndarja e roleve, gjetja e materialeve, kontaktimi me institucione.</li><li>2. Zbatimi i aktivitetit: si e zbatuan aktivitetin, përshkrim i aktivitetit, sfidat gjatë zbatimit të aktivitetit.</li><li>3. Arritjet nga aktiviteti: si u ndjenë gjatë aktivitetit, a do ta bëjnë përsëri?</li></ol> <p>Këto punime mund të prezantohen në rrjete sociale, në ditë të shkollës, apo gjatë mbledhjeve të prindërve.</p>
<p><b>Koment</b></p>	<p>Në rast të publikimit të punëve vullnetare, ju lutem na dërgoni fotografi ose postime në rrjetet sociale (Facebook: Kosovar Youth Council; Instagram: kyckosova apo në emailin: <a href="mailto:kyckosova@gmail.com">kyckosova@gmail.com</a>)</p>

<b>Titulli</b>	<b>Bamirësia</b>
<b>Qëllimi</b>	Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	Bamirësia: Dhënia vullnetare e ndihmës për ata në nevojë.
<b>Materialet</b>	<p>Opsioni 1: Aneksi “Plani i Punës” printohet për secilin nxënës.</p> <p>Opsioni 2: Aneksi “Plani i Punës” paraqitet në projektor dhe nxënësit e kopjojnë në fletë.</p> <p>Opsioni 3: Aneksi “Plani i Punës” vizatohet në tabelë dhe nxënësit e kopjojnë në fletë.</p>
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Filloni duke i pyetur nxënësit se çka dijnë rreth organizimeve të bamirësisë dhe nëse ndonjëherë kanë marrë pjesë në organizime të tilla. I shkruani në tabelë disa nga organizimet që nxënësit i përmendin. Nëse ka mungesë të ideve, i përmendni disa nga këta shembuj:</p> <p>Marrja e ushqimit nga shtëpia çdo ditë, por të caktohet që secili nxënës nga një herë të sjell nga dy shujta për shokët ose shoqet në nevojë.</p> <p>Mbledhje e rrobave për fëmijë në nevojë.</p> <p>Maratonë vrapimi mes bashkëmoshatarëve në park.</p> <p>Nxënësit ndahen në grupe dhe vendosin se cilin organizim bamirës do ta organizojnë dhe duhet të fokusohen në këto pjesë. Gjatë përgjigjeve në pyetje, duhet të bëhet plotësimi i aneksit “Plani i Punës” që përmban aktivitetet për zbatimin e projektit, personat përgjegjës për secilin aktivitet, kohën e përfundimit dhe statusin. Kushdo që do të udhëheq grupin ka për detyrë të analizojë nëse aktivitetet janë përfunduar me kohë.</p>
<b>Udhëzimet</b>	<p>1. Ndarja e roleve dhe përgjegjësi – 5 minuta. Grupi cakton se kush do të mirret me cilat detyra: udhëheqje dhe organizim, marketingun, financa (mbledhjen dhe shpërndarjen e parave), dhe tjera detyra sipas nevojës. <i>Preferohet që këto role të diktohen për nxënësit, ose të shkruhen në tabelë.</i></p> <p><i>Pas 5 minutave, mësimmshënësi lexon dhe qartëson:</i></p> <p>2. Caktimi i qëllimit të organizimit dhe korniza kohore – 15 minuta. Grupi vendosë së çfarë dëshirojnë të arrijnë përmes organizimit, kujt dëshirojnë ti ndihmojnë, dhe caktojnë kornizën kohore (p.sh. 1 javë kohë për organizim, pastaj 1 javë marketing dhe shpërndarje të ftesave). <i>Preferohet që këto pikë të diktohen për nxënësit, ose të shkruhen në tabelë.</i></p>

*Pas 15 minutave, mësuesi lexon dhe qartëson:*

3. Organizimi i Bamirësisë – 15 minuta. Grupi qartëson dhe mendon për të gjithë logjikën: ku do të mbahet, kush do të ftohet, si do të ftohen, çfarë do të përmbajë i gjithë organizimi, kush do të merret me ftesa, kush do të merret me fotografi, dhe të gjitha pyetjet e ndërlidhura. *Preferohet që këto pikë të diktohen për nxënësit, ose të shkruhen në tabelë.*

Në fund, të gjitha grupeve do t'u kërkohet të paraqesin të gjitha informacionet, idetë dhe të dhënat e tjera që i kanë nxjerr nga pikët e lartë-përmendura. Hapet diskutim në klasë nëse kanë ide shtesë për projektet individuale.

### **Detyrë**

Kërkohet që nxënësit e klasës VIII deri XII të organizojnë të paktën një aktivitet bamirësie për klasë.

### Aneksi “Plani i Punës”

*Aktiviteti:* Shkruaj të gjitha aktivitetet me radhë që duhet ti zbatoni për projektin tuaj.

*Personat Përgjegjës:* Shkruani emrat ose grupet e personave përgjegjës për secilin aktivitet.

*Data e Përfundimit:* Shkruani datën se kur do të përfundojë aktiviteti.

*Statusi:* Shkruani statusin e projektit – (1) nuk ka filluar; (2) në progres; (3) ka përfunduar.

Për shembull:

Aktiviteti	Personat Përgjegjës	Data e përfundimit	Statusi
1 Dizajni i ftesave për aheng	Arta, Arti	15 maj 2020	Në progres

### Plani i punës

Projekti: \_\_\_\_\_

	Aktiviteti	Personat Përgjegjës	Data e përfundimit	Statusi
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				

**Disa aktivitete:**

	<b>Aktiviteti</b>	<b>Personat Përgjegjës</b>	<b>Data e përfundimit</b>	<b>Statusi</b>
1	Caktimi i përgjegjësive			
2	Caktimi i vendit			
3	Dizajni i ftesave			
4	Krijimi i eventit në rrjete sociale			
5	Shpërndarja e ftesave			
6	Identifikimi dhe gjetja e materialeve			
7	Organizimi i aktiviteteve			
8	Përpilimi i agjendës			
9	Përgatitja e sallës/vendit të ngjarjes			

<b>Titulli</b>	<b>Krijimi i vlerave</b>
<b>Qëllimi</b>	Zhvillimi i aftësive praktike, strategjike dhe kreative duke punuar dhe komunikuar në grupe.
<b>Niveli</b>	Klasa 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Materialet</b>	<p>5 letra të trasha A3, letër për hamera</p> <p>5 gërshërë</p> <p>5 ngjitës, ose spango</p> <p>100 kapëse letre</p> <p>5 lapsa me ngjyrë</p> <p>Nëse nuk i keni këto materiale, bëni bashkë materialet që mund të grumbulloni nga ato që janë në klasë.</p> <p>Kujdes: secili grup duhet të ketë materialet e ngjashme të punës.</p>
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Krijoni 5 grupe me numër të barabartë të nxënësve. Secili grup duhet të ndërtojë një urë me materialet e dhëna. Ura duhet të jetë e qëndrueshme dhe e gjatë të paktën 20 cm. Grupi fitues është ai grup që e ka urën më të qëndrueshme. Forma e urës nuk ka rëndësi. Ndërtimi i urës duhet të zgjatë rreth 25 minuta.</p> <p>Grupi duhet të përcaktojë idenë, llojin e urës, formën e saj dhe se si do të jetë procedura e ndërtimit.</p> <p>Pasi të përfundojnë 25 minuta, të gjitha punimet do të analizohen dhe prezantohen nga një përfaqësues i grupit. Detyra e përfaqësuesit të grupit është të tregojë se pse ura e grupit është më e qëndrueshme se tjerat. Pastaj, zgjidhet fituesi me vota ose nga një person i tretë.</p>
<b>Diskutim</b>	<p>Si ju shkoi aktiviteti?</p> <p>Cila ishte strategjia juaj?</p> <p>A kishit ndonjë konflikt në grup? Nëse po, si e keni zgjidhur konfliktin?</p>



<b>Titulli</b>	<b>Për mjedisin</b>
<b>Qëllimi</b>	Angazhim për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.
<b>Niveli</b>	Klasa 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Definicionet dhe fjalët kyçe</b>	Aktivist: Një person që bën fushata për të sjellë ndryshime politike ose shoqërore.
<b>Materialet</b>	Varësisht nga përzgjedhja e punës vullnetare.
<b>Kohëzgjatja</b>	90 minuta: 45 minuta planifikim; 45 minuta prezantim dhe fillim i punës për mjedisin
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	Kërkoni nga secili nxënës të përgjigjet në pyetjen e mëposhtme:
<b><i>Pjesa e parë</i></b>	Nëse mund të zgjidhni një problem mjedisor në botë, cili do të ishte ai?
<b>Planifikimi dhe ndarja e roleve</b>	Jepini rreth dhjetë minuta për t'u përgjigjur nxënësve, pastaj ndajini në çifte dhe kërkoni që ata të ndajnë mendimet e tyre në çift, e pastaj kërkoni vullnetarë të ndajnë mendimet e tyre për gjithë klasën.
<b>45 minuta</b>	<p>Pastaj, kërkoni nga nxënësit të mendojnë për një problem mjedisor në Kosovë dhe të ju përgjigjen këtyre pyetjeve:</p> <p>A është ky një problem për të cilin mund të bëj diçka?</p> <p>Çfarë mund të bëj?</p> <p>Çfarë do të thotë të jesh aktivist?</p> <p>Cili mendoni se është dallimi midis një personi që kujdeset për mjedis dhe një aktivisti mjedisor?</p> <p>Pasi nxënësit të kenë diskutuar idetë e tyre, krijoni një tabelë në klasë që përmbledh mendimet e nxënësve për atë që të rinjtë mund të ndryshojnë dhe çfarë nuk mundën ndryshojë. Postoni listën për t'u përdorur si burim në klasë dhe inkurajoni studentët të shtojnë ide të reja.</p> <p>Në pjesën e fundit të klasës, përzgjidhni bashkë me klasën idetë më të realizueshme për zgjidhjen e një problemi mjedisor në Kosovë dhe vendosni për një aktivitet që do ta bëni bashkë me nxënësit për përmirësimin e gjendjes. Organizimi i aktivitetit mund të ndjekë udhëzimet nga aktiviteti “Puna Vullnetare” dhe aneksin “Plani i Punës”. Aktiviteti mund të jetë i bazuar në përgjigjet e nxënësve për pyetjet më lartë.</p> <p>Disa ide shtesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbjellja e fidanëve në shkollë</li> <li>2. Mbledhja e shisheve të plastikës dhe dërgimi i tyre në kompani të riciklimit</li> <li>3. Fillimi i një fushate recikluese në shkollë</li> <li>4. Punë dore e stoleve dhe objekteve të tjera përmes materialeve për</li> </ol>

	<p>reciklim që mund të përdoret për nevoja të ndryshme të shkollës</p> <p>5. Zhvillim të kampanjave/aktiviteteve vetëdijësuese se si të mënjanohet përdorimi i plastikës, të mos hudhet ushqimi dhe të përdoret çdo material deri në maksimum (p.sh të shënohet në të dy anët e letrës)</p>
<b><i>Pjesa e dytë</i></b> <b>Zbatimi dhe</b> <b>prezentimi</b> <b>45 minuta</b>	<p>Caktoni një datë që aktiviteti për mjedisin duhet të përfundohet – preferohet të ju lejohet rreth 1 muaj kohë për dizajn dhe zbatim të aktivitetit. Mësimdhënësi/lehtësuesi duhet të ndjek punën e nxënësve gjatë gjithë kohës.</p> <p>Pas një muaji, kërkoni nga nxënësit të bëjnë një prezantim rreth punës së tyre dhe kërkoni të bëjnë fotografi gjatë gjithë procesit:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Dizajni i aktivitetit: organizimi, ndarja e roleve, gjetja e materialeve, kontaktimi me institucione.</li><li>2. Zbatimi i aktivitetit: si e zbatuan aktivitetin, përshkrim i aktivitetit, sfidat gjatë zbatimit të aktivitetit.</li><li>3. Arritjet nga aktiviteti: si u ndjenë gjatë aktivitetit, a do ta bëjnë përsëri?</li></ol> <p>Këto punime mund të prezantohen në rrjete sociale, në ditë të shkollës, apo gjatë mbledhjeve të prindërve.</p>
<b><i>Koment</i></b>	<p>Në rast të publikimit të punëve vullnetare, ju lutem na dërgoni fotografi ose postime në rrjetet sociale (Facebook: Kosovar Youth Council; Instagram: kyckosova apo në emailin: <a href="mailto:kyckosova@gmail.com">kyckosova@gmail.com</a>)</p>

<b>Titulli</b>	<b>Ushqimi i shëndetshëm</b>
<b>Qëllimi</b>	Të bëjnë zgjedhje dhe të marrin vendime të informuara lidhur me shëndetin, dietat dhe ushtrimet.
<b>Niveli</b>	Klasa 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Diskutoni me klasën se cilat janë ushqimet e shëndetshme dhe i shkruani ato në tabelë.</p> <p>Shpjegoni grupet e ushqimit. Për më shumë informata, referojuni kësaj uebfaqeje: <a href="https://psikosociale.org/grupet-e-prodhimeve-ushqimore/">psikosociale.org/grupet-e-prodhimeve-ushqimore/</a></p> <p>Pastaj, nxënësit ndahen në grupe në mënyrë të barabartë në klasë.</p> <p><i>Udhëzime</i></p> <p>Imagjinoni që jeni duke hapur një restaurant vetëm me ushqim të shëndetshëm, dhe keni vetëm nga një shujtë për mëngjes, drekë dhe darkë. Lëni një emër restaurantit. Krijoni një meny të shëndetshme ushqimore: mëngjes, drekë dhe darkë për rreth 20 minuta. Ju duhet të dizajnoni menytë dhe të shkruani: emrin e ushqimit, përbërësit dhe cilit grup i takojnë, dhe të shpjegoni përse janë të shëndetshme. Pas përfundimit të menysë prezantoni ato para klasës dhe tregoni se si keni bërë përzgjedhjen e ushqimeve, dhe se cilit grup i takojnë ato.</p> <p>Opsionale: Kërkoni nga nxënësit të bëhen bashkë në grupe dhe të përgatisin ushqime të shëndetshme: p.sh. biskota të shëndetshme dhe ti shesin ato gjatë pushimit të gjatë; ky aktivitet mund të bëhet si pjesë e klubit të bamirësisë i cili mund të themelohet në shkollë (shih aktivitetin: Puna Vullnetare).</p>

<b>Titulli</b>	<b>Aktivitetet Kulturore dhe Promovimi i tyre</b>
<b>Qëllimi</b>	Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore.
<b>Niveli</b>	Klasa 8, 9, 10, 11, 12
<b>Kohëzgjatja</b>	45 minuta
<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<p>Nxënësit ndahen në grupe nga pesë deri në gjashtë nxënës. Nga secili grup kërkohet që të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikojnë aktivitetet kulturore dhe shoqërore në qytet (mund të përdoret interneti për hulumtim);</li> <li>2. Të prezantojnë para klasës këto aktivitete.</li> </ol> <p>Të gjitha aktivitetet paraqiten në tabelë (5 minuta).</p> <p>Pastaj, pyeten të gjithë nxënësit (5 minuta):</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ku i gjeni informatat për aktivitete kulturore në qytet?</li> <li>2. Cilat janë disa metoda për promovimin e këtyre aktiviteteve?</li> </ol> <p>Përgjigje: rrjete sociale, broshura, televizion.</p> <p>Pasi të identifikohen aktivitetet kulturore dhe metodat për promovimin e tyre, kërkoni nga secili grup të zgjedhin një aktivitet kulturor dhe të bëjnë promovimin e tyre (20 minuta). Informatat duhet të tregojnë rreth aktivitetit, ku do të mbahet, në sa ora, dhe një kuriozitet se përse është aktivitet që duhet të përcillet; shih shembullin më poshtë.</p> <p>Grupet mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Krijojnë një broshurë</li> <li>Krijojnë një poster</li> <li>Simulojnë një reklamë</li> <li>Bëjnë planin e postimit në rrjetet sociale etj.</li> </ul> <p>Pasi të përgatiten, secili grup bën prezentimin para klasës të aktivitetit të përzgjedhur. Nxënësit mund të votojnë për paraqitjen më të mirë.</p>



